www.qbz.gov.al

# FLETORJA ZYRTARE
## E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare

Viti: 2015 – Numri: 116

**Tiranë – E hënë, 6 korrik 2015**

## PËRMBAJTJA


| | | Faqe |
|---|---|---|
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 520, datë 12.6.2015 | Për ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, për Autoritetin Rrugor Shqiptar, të disa objekteve dhe të sipërfaqes truall funksional, brenda territorit të pronës nr. 906, me emërtim "Reparti ushtarak nr. 7008, Fakulteti Teorik", me vendndodhje në Vlorë, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes", të ndryshuar............................ | 6059 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 563, datë 24.6.2015 | Për financimin e TVSH-së dhe lejeve administrative për zbatimin e projektit strategjik "Përmirësimi i infrastrukturës ndërkufitare", në kuadër të programit të bashkëpunimit ndërkufitar Shqipëri – Mali i Zi, komponenti II, IPA 2007-2013........................................................ | 6061 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 564, datë 24.6.2015 | Për kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Drejtësisë të pronës së paluajtshme shtetërore, të ndodhur në zonën kadastrale 8591, për ngritjen e ndërtesës së re të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër........................................................................................................ | 6061 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 565, datë 24.6.2015 | Për një ndryshim në vendimin nr. 536, datë 1.5.2008, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, që transferohen në pronësi ose në përdorim të bashkisë Durrës, të qarkut të Durrësit".................................................. | 6063 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 566, datë 24.6.2015 | Për një ndryshim në vendimin nr. 421, datë 2.6.2010, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës përfundimtare (të pjesshme) të pronave të paluajtshme publike, që transferohen në pronësi ose në përdorim të bashkisë Shkodër, të qarkut të Shkodrës"........................ | 6066 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 567, datë 24.6.2015 | Për financimin e kostos së menaxhimit të projekteve që zbatohen nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit.............................................................. | 6069 |

| | | |
|---|---|---|
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 568, datë 24.6.2015 | Për dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë me tarifën 1 euro/kontrata, ndërmjet Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, si qiradhënës, dhe shoqërisë "Lubima" sh.p.k., si qiramarrës, për pasurinë "Kodra, Qafa e Buallit", në bashkinë Bulqizë | 6069 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 569, datë 24.6.2015 | Për miratimin e bonusit në procedurën përzgjedhëse konkurruese, që i jepet shoqërisë, për dhënien me koncesion të hidrocentralit "Osojë" | 6069 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 571, datë 24.6.2015 | Për një shtesë në vendimin nr. 286, datë 6.4.2011, të Këshillit të Ministrave, "Për licencimin e shkollës së lartë private "Bedër" (Hëna e Plotë), Tiranë" | 6070 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 572, datë 24.6.2015 | Për miratimin e standardeve të shërbimeve në Qendrën Kombëtare Transitore të Emergjencës | 6070 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 573, datë 24.6.2015 | Për miratimin e standardeve të shërbimeve të Njësive të Mbrojtjes së Fëmijëve | 6092 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 574, datë 24.6.2015 | Për kriteret e tregtimit, certifikimit dhe testimit të farës së patates | 6122 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 575, datë 24.6.2015 | Për miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte | 6135 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 576, datë 24.6.2015 | Për shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i linjës 110 kv Llapaj – Peshkopi | 6137 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 577, datë 24.6.2015 | Për ngritjen e rrjetit të njësive të integrimit evropian dhe rrjetit të njësive të hartimit të legjislacionit në ministritë e linjës | 6138 |
| Vendim i Këshillit të Ministrave nr. 578, datë 24.6.2015 | Për një shtesë në vendimin nr. 545, datë 11.8.2011, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, zëvendësministrit dhe nëpunësve të kabineteve në Kryeministri, aparatet e ministrive të linjës, administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Prokurorinë e Përgjithshme, disa institucione të pavarura, institucionet në varësi të kryeministrit, institucionet në varësi të ministrave të linjës dhe administratën e prefektit", të ndryshuar | 6140 |

# VENDIM
## Nr. 520, datë 12.6.2015

## PËR NDRYSHIMIN E PËRGJEGJËSISË SË ADMINISTRIMIT, NGA MINISTRIA E MBROJTJES TE MINISTRIA E TRANSPORTIT DHE INFRASTRUKTURËS, PËR AUTORITETIN RRUGOR SHQIPTAR, TË DISA OBJEKTEVE DHE TË SIPËRFAQES TRUALL FUNKSIONAL, BRENDA TERRITORIT TË PRONËS NR. 906, ME EMËRTIM "REPARTI USHTARAK NR. 7008, FAKULTETI TEORIK", ME VENDNDODHJE NË VLORË, DHE PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 515, DATË 18.7.2003, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE,"PËR MIRATIMIN E LISTËS SË INVENTARIT TË PRONAVE TË PALUAJTSHME SHTETËRORE, QË I KALOJNË NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI MINISTRISË SË MBROJTJES", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 13 e 15, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001,"Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ndryshimin e përgjegjësisë së administrimit, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, për Autoritetin Rrugor Shqiptar, të disa objekteve dhe të truallit funksional, me sipërfaqe të përgjithshme 3 636.8 (tremijë e gjashtëqind e tridhjetë e gjashtë pikë tetë) m², brenda territorit të pronës nr. 906, me emërtim "Reparti Ushtarak nr. 7008, Fakulteti Teorik", me vendndodhje në Vlorë, sipas planvendosjes që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij, për t'u përdorur për ndërtimin e rrugës nacionale automobilistike Transballkaniku Fier-Vlorë.

2. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, që i bashkëlidhet vendimit nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, të hiqen objektet dhe trualli funksional, me sipërfaqe të përgjithshme 3636.8 (tremijë e gjashtëqind e tridhjetë e gjashtë pikë tetë) m², nga objektet dhe trualli funksional i pronës nr. 906, me emërtim "Reparti Ushtarak nr. 7008, Fakulteti Teorik", me vendndodhje në Vlorë, sipas planvendosjes që i bashkëlidhet vendimit, dhe të shtohen në listën e inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore që i kanë kaluar në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës.

3. Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës dhe Autoritetit Rrugor Shqiptar u ndalohet të ndryshojnë destinacionin e sipërfaqes së pronës, të përcaktuar në pikën 1 të këtij vendimi, ta tjetërsojnë atë ose t'ua japin në përdorim të tretëve.

4. Për sigurinë dhe ruajtjen e pronës së Forcave të Armatosura, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, nëpërmjet Autoritetit Rrugor Shqiptar, të ndërtojë rrethimin, në kufijtë e rinj, të pronës, të kryejë spostimin e rrjeteve inxhinierike që prek gjurma e rrugës, sipas parametrave dhe kushteve teknike, duke i kthyer ato në gjendjen e tyre të mëparshme. Për këtë qëllim, të hartohet një aktmarrëveshje e përbashkët, ndërmjet Ministrisë së Transportit dhe Infrastrukturës, Autoritetit Rrugor Shqiptar dhe Komandës së Forcës Ajrore të Ministrisë së Mbrojtjes.

5. Vendimi nr. 357, datë 29.4.2015, i Këshillit të Ministrave, "Për kalimin në përdorim, pa shpërblim, Drejtorisë së Përgjithshme të Arkivave, të objektit nr. 2, me dy kate, pjesë e pronës nr. 906, me emërtim "Reparti Ushtarak nr. 7008, Fakulteti Teorik", në Vlorë, shfuqizohet.

6. Ngarkohen ministri i Mbrojtjes, ministri i Transportit dhe Infrastrukturës, Agjencia e Inventarizimit dhe Transferimit të Pronave të Paluajtshme dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Edi Rama**


Planvendosja e Rep.Usht. 3331 Shkolla e Aviacionit Vlore (Prona nr.906)
"Sipërfaqja që preket nga projekti i rrugës Transballkanike"
MIRATOHET
Komandant Forcës Ajrore
Kolonel Mehmet METKO
RRUGA TRANS BALLKANIKE
PRONE PRIVATE
RRUGE
Shpjeguese.
Sipërfaqja që zë projekti Rrugës = 3636.8 m2
Kufi reparti
Shenim Kjo Plan vendosje u përgatit në zbatim të shkresës me nr.1244/1 dt.18.02.2015 të SH.SH.P.F.A-së.
Projekti i rrugës Transballkanike u mbivendos mbi planvendosjen e kësaj prone marrë nga arkivi i I.GJ.I.U-së
Punuar Prill 2015
483779
483879
483979
Shkalla 1 : 1000
Përgj.Sek. Ramiz HAXHIU

**VENDIM**
**Nr. 563, datë 24.6.2015**

**PËR FINANCIMIN E TVSH-së DHE LEJEVE ADMINISTRATIVE PËR ZBATIMIN E PROJEKTIT STRATEGJIK "PËRMIRËSIMI I INFRASTRUKTURËS NDËRKUFITARE", NË KUADËR TË PROGRAMIT TË BASHKËPUNIMIT NDËRKUFITAR SHQIPËRI – MALI I ZI, KOMPONENTI II, IPA 2007 - 2013**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 26, të marrëveshjes kuadër, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit të Komuniteteve Evropiane, për rregullat e bashkëpunimit për asistencën për Shqipërinë, në kuadër të zbatimit të Instrumentit të Asistencës së Parazgjerimit (IPA), të ratifikuar me ligjin nr. 9840, datë 10.12.2007, të nenit 5, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të nenit 13, të ligjit nr. 160/2014, "Për buxhetin e vitit 2015", dhe të marrëveshjes së financimit, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Komisionit Evropian, për programin ndërkufitar ndërmjet Shqipërisë dhe Malit të Zi, nën Instrumentin e Asistencës së Paraanëtarësimit (IPA), komponenti i bashkëpunimit ndërkufitar, për vitin 2012 - 2013", me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Financimin e vlerës së TVSH-së dhe lejeve administrative në shumën 39 400 000 (tridhjetë e nëntë milionë e katërqind mijë) lekë, për zbatimin e komponentit të infrastrukturës dhe të supervizionit për projektin strategjik "Përmirësimi i infrastrukturës ndërkufitare", në kuadër të programit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA, Shqipëri - Mali i Zi, komponenti II.

2. Fondit Shqiptar të Zhvillimit i shtohet vlera e financimit të TVSH-së në zërin "TVSH dhe taksë doganore", kapitulli 04, e shtrirë në vite, si më poshtë vijon:

a) 8 040 000 (tetë milionë e dyzet mijë) lekë, për vitin 2015;

b) 31 360 000 (tridhjetë e një milionë e treqind e gjashtëdhjetë mijë) lekë, për vitin 2016.

3. Efekti financiar sipas shkronjës "a", të pikës 2, prej 8 040 000 (tetë milionë e dyzet mijë) lekësh, të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit për vitin 2015.

4. Efekti financiar sipas shkronjës "b", të pikës 2, prej 31 360 000 (tridhjetë e një milionë e treqind e gjashtëdhjetë mijë) lekësh, të parashikohet në planin e buxhetit të shtetit për vitin 2016.

5. Ngarkohen Ministria e Financave dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Edi Rama**

**VENDIM**
**Nr. 564, datë 24.6.2015**

**PËR KALIMIN NË PËRGJEGJËSI ADMINISTRIMI TË MINISTRISË SË DREJTËSISË TË PRONËS SË PALUAJTSHME SHTETËRORE, TË NDODHUR NË ZONËN KADASTRALE 8591, PËR NGRITJEN E NDËRTESËS SË RE TË GJYKATËS SË RRETHIT GJYQËSOR SHKODËR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 8, pika 3, 10, 13 e 14, të ligjit nr. 8743, datë 22.2.2001, "Për pronat e paluajtshme të shtetit", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Kalimin në përgjegjësi administrimi të Ministrisë së Drejtësisë të truallit me sipërfaqe 2 000 (dy mijë) $m^2$, të ndodhur në zonën kadastrale 8591, sipas formularit dhe planvendosjes që i bashkëlidhen këtij vendimi, që do të shërbejë për ngritjen e ndërtesës së re të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Shkodër.

2. Ministrisë së Drejtësisë i ndalohet të ndryshojë destinacionin e pronës së përcaktuar në pikën 1, të këtij vendimi.

3. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Drejtësisë, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkia Shkodër për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Edi Rama**

| Bashkia Shkodër<br>Fusha e përdorimit të pronës: Administrative | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | **A** | | | **B** | | | **C** | | | |
| **Nr. rendor** | **Zona Kadastrale dhe indeksi i hartës** | **Nr. i pasurisë** | **Lloji i pronës** | **Emri i pronës Adresa** | **Sip.totale e pronës (m²)** | **Nga sip. totale sa ndërtesë (m²)** | **Funksioni për të cilin përdoret prona** | **Institucioni/ Enti me përgjegjësi administrative** | **Institucioni/Enti përdorues Statusi juridik i përdorimit** | **Të dhëna të tjera (shënime të veçanta)** |
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 |
| 858 | 8591 P-5 | 4/211 | Truall | Rruga "Ethem Osmani" | 1270 | | Shesh për ndërtimin e Gjykatës së Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor Shkodër | | | |
| 858/1 | 8591 P-5 | 4/212 | Truall | Rruga "Ethem Osmani" | 178 | | Shesh për ndërtimin e Gjykatës së Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor Shkodër | | | |
| 858/2 | 8591 P-5 | 4/298 | Truall | Rruga "Ethem Osmani" | 552 | | Shesh për ndërtimin e Gjykatës së Shkallës së Parë të Rrethit Gjyqësor Shkodër | | | |



**VENDIM**
**Nr. 565, datë 24.6.2015**

**PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 536, DATË 1.5.2008, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË DURRËS, TË QARKUT TË DURRËSIT"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3/a, 5, 8 e 17, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në listën e inventarit të pronave të paluajtshme publike shtetërore, brenda juridiksionit territorial dhe administrativ të Bashkisë Durrës, Qarku Durrës, bashkëlidhur vendimit nr. 536, datë 1.5.2008, të Këshillit të Ministrave, shtohet prona me nr. 1841, gjithsej 1 (një) pronë.

2. Prona me numër rendor 1841, e llojit "truall", me sipërfaqe 700 (shtatëqind) m$^2$, sipas formularit dhe planimetrisë që i bashkëlidhen këtij vendimi, kalon në pronësi të Bashkisë Durrës për t'u përdorur për ndërtimin e një qendre multifunksionale.

3. Bashkisë Durrës i ndalohet ta ndryshojë destinacionin e pronës të përcaktuar në pikën 2, të këtij vendimi, ta tjetërsojë ose t'ua japë në përdorim të tretëve.

4. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe Bashkia Durrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Edi Rama**

**1. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE**
**(Per inventarizimin e pronave te veçanta)**

Bashkia / Komuna: **Durres**
Fusha e perdorimit te Prones: **Administrata**

Identifikoi: **Mimoza Dyrmishi(specialiste)** **Rozeta Kovaçi(specialite)**
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)
Supervizoi: **Anila Myderrizi** Pergj. i Zyres se Pronave
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)
Aprovoi: **Vangjush Dako** Kryetar i bashkise
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel, firma, vula)

KRYETARI I BASHKISE DURRES VANGJUSH DAKO

| Nr. Rend. | A | | | B | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes | Nr. Pasurise | Lloji i Prones | Emri i Prones Adresa | Sip. Totale e Prones (m2) | Nga Sip. Totale: Sa Ndertese (m2) | Funksioni per te cilin perdoret Prona | Institucioni / Enti me pergjegjesi administrative | Institucioni / Enti perdorues Statusi juridik i perdorimit | Te dhena te tjera (Shenime te veçanta) |
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 |
| 1841 | 8517 | | ndertese | Zyrat e Qendres Administrative nr.6 L.14 Bashkia Durres | | | Administrate | Bashkia Durres | Bashkia Durres | Kati I pare godina e I.C.M.C |
| | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | |
| | | | | | | | | | | |

# PLAN RILEVIMI

| PERGATITI | IDENTIFIKIMI I PASURISE |
|---|---|
| Departamenti Urbanistikes<br>Kadastra Urbane | ZONA KADASTRALE ..... 8517 ...... |
| Ing . I Tomori | Nr i pasurise ........... Vol ........... Fq. ........ |
| Tek. M Kertusha | Indeksi i Hartes .... K- 34 - 99 ( 16 - A ) ....... |
| Sektori i Aseteve | Shkalla ... 1/2500........ Siperfaqja 700 m2 |
| A Muka | Adresa e Pasurise<br>Rrethi .. Durres .. |
| | Q ... Durres..... Rr ... ......... ..... L 17<br>P / G .................... Sh .......... K ........ Ap ........ |
| firma / vula | PRONARI Bashkia Durres |



**Pasuria Nr ............**
Sip 700 m²

**KUFIZIMET**

Veri .....................pas. nr ....... (rruge)
Lindje ...................pas. nr ....... ( rruge)
Jug .......................pas. nr ....... ( rruge)
Perendim .............pas. nr ....... ( objekt )

**MIRATOHET**

**Kryetari i Bashkise**

**VANGJUSH DAKO**

**DREJTORI I PLANIFIKIMIT DHE KONTROLLIT TE TERRITORIT**

**PER SEKTORIN E PRONAVE DHE MENAXHIMIT TE ASETEVE**

PLAN - VENDOSJA PASURISE NR .......................
dhe objekti brenda saj
ne pronesi te : Bashkise Durres

**Zyrat administrative Rajoni 6 ( ish Keneta )**



## VENDIM
## Nr. 566, datë 24.6.2015

## PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 421, DATË 2.6.2010, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE (TË PJESSHME) TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, QË TRANSFEROHEN NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM TË BASHKISË SHKODËR, TË QARKUT TË SHKODRËS"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 8/a, të ligjit nr. 8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Punëve të Brendshme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Revokimin e kalimit të së drejtës së pronësisë Bashkisë Shkodër për pronat me numër rendor 619 dhe 620, të listës së lidhjes 1, që i bashkëlidhet vendimit nr. 421, datë 2.6.2010, të Këshillit të Ministrave, sipas formularit që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

2. Ngarkohen Ministria e Punëve të Brendshme, Bashkia Shkodër dhe kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Edi Rama**

3. FORMULAR PER INVENTARIZIMIN E PRONAVE TE PALUAJTSHME SHTETERORE
(Te tipit te pronave qe inventarizohen si klasa te veçanta)

Bashkia Shkoder

Identifikoi: Nedret Qehaja Specialiste topografe
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)
Supervizoi: Kujtim Domnori Specialist inxhinier
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar)
Aprovoi: Artan Haxhi Kryetar Bashkie Tel 02243720
(emri, mbiemri, pozicioni zyrtar, tel., firma, vula)

Fusha e perdorimit te Prones: Transporti Publik

| | A | | B | | | | C | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Nr. Rend | Zona Kadastr. Indeksi i Hartes | Nr. Pasurise | Emertesa e Prones Vend ndodhja / Shtrirja Gjeografike | Komponentet perberes te Prones | Adresa/Vend ndodhja e komponenteve perberes | Permasat e Prones ne $m^2$ ose ml | Funksioni per te cilin perdoret Prona | Institucioni/Enti me pergjegjesi administrative | Institucioni/Enti perdorues Statusi juridik i perdorimit | Te dhena te tjera (Shenime te veçanta) |
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 |
| 618 | 8592 | 11/31 | zyra | agjensi | prane fermentimit | 136 | nuk perdoret | DRSHTRR | DRSHTRR | zene |
| 619 | 8592 | 10/4 10/1 | Parku Transportit Urban | shesh | Pas ish-korpusit | 9020 | shesh funksional | Parku Transportit Urban | Parku Transportit Urban sh.a | |
| 620 | 8592 | 10/4 10/1 | Parku Transportit Urban | zyra+magazina | Pas ish-korpusit | 2650 | zyra+magazina | Parku Transportit Urban | Parku Transportit Urban sh.a | |


HARTE TREGUESE
A.IDENTIFIKIMI I PASURISE
ZONA KADASTRALE
NUMRI I PASURISE
VOL.
FAQE.
INDEKSI I HARTES :
SHKALLA :
1:500
ADRESA E PASURISE: RRETHI : SHKODER
Q/F: SHKODER
RR/L:
P/G:
Sh.
K.
Ap.
PRONARI
B.Kufizimet
ZYRA E REGJISTRIMIT TE PASURIVE TE PALUAJTSHME
SHKODER
Hart: N. ZAMBAKU
Z.V.R.P.P. SHKODER


10/13
z.K. 8592
10/7
10/6
10/63

**VENDIM**
**Nr. 567, datë 24.6.2015**

## PËR FINANCIMIN E KOSTOS SË MENAXHIMIT TË PROJEKTEVE QË ZBATOHEN NGA FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 10, të ligjit nr. 160/2014, "Për buxhetin e vitit 2015", dhe të neneve 6, pikat 2, shkronja "a", e 4, dhe 8, pika 1, shkronja "b", të ligjit nr. 10130, datë 11.5.2009, "Për Fondin Shqiptar të Zhvillimit", me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Financimin e kostos së menaxhimit të projekteve të qeverisë shqiptare që zbatohen nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit, në një vlerë, jo më shumë se 98 000 000 (nëntëdhjetë e tetë milionë) lekë, e cila të përballohet nga zëri "Kosto lokale", miratuar në buxhetin e vitit 2015 për Fondin Shqiptar të Zhvillimit.
2. Ngarkohet Fondi Shqiptar i Zhvillimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Edi Rama**

**VENDIM**
**Nr. 568, datë 24.6.2015**

## PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PËR LIDHJEN E KONTRATËS SË QIRASË ME TARIFËN 1 EURO/KONTRATA, NDËRMJET MINISTRISË SË ZHVILLIMIT EKONOMIK, TURIZMIT, TREGTISË DHE SIPËRMARRJES, SI QIRADHËNËS, DHE SHOQËRISË "LUBIMA" SHPK, SI QIRAMARRËS, PËR PASURINË "KODRA, QAFA E BUALLIT", NË BASHKINË BULQIZË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe në vijim të vendimit nr. 54, datë 5.2.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Dhënien e miratimit për lidhjen e kontratës së qirasë me tarifën 1 euro/kontrata, ndërmjet Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, si qiradhënës, dhe shoqërisë "Lubima" sh.p.k., si qiramarrës, për pasurinë "Kodra, Qafa e Buallit", shesh, truall i lirë, në administrim të Bashkisë Bulqizë, me sipërfaqe të përgjithshme 12 200 (dymbëdhjetë mijë e dyqind) $m^2$.
2. Ngarkohet Ministria e Zhvillimit Ekonomik, Turizmit, Tregtisë dhe Sipërmarrjes, për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Edi Rama**

**VENDIM**
**Nr. 569, datë 24.6.2015**

## PËR MIRATIMIN E BONUSIT NË PROCEDURËN PËRZGJEDHËSE KONKURRUESE, QË I JEPET SHOQËRISË, PËR DHËNIEN ME KONCESION TË HIDROCENTRALIT "OSOJË"

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 7, të ligjit nr. 125/2013, "Për koncesionet dhe partneritetin publik privat", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e bonusit prej 2 (dy) pikësh, për rezultatin teknik dhe financiar në procedurën përzgjedhëse konkurruese për dhënien me koncesion të hidrocentralit "Osojë", që i jepet shoqërisë "Osoja Energy" sh.p.k.
2. Ministria e Energjisë dhe Industrisë, në procedurën përzgjedhëse konkurruese për dhënien me koncesion të hidrocentralit "Osojë", duhet të pranojë oferta për të gjithë pjesën e lirë të pellgut ujëmbledhës, i cili përfshihet në skemën e shfrytëzimit të këtij hidrocentrali.
3. Ngarkohet Ministria e Energjisë dhe Industrisë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Edi Rama**

**VENDIM**
**Nr. 571, datë 24.6.2015**

**PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 286, DATË 6.4.2011, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR LICENCIMIN E SHKOLLËS SË LARTË PRIVATE "BEDËR" (HËNA E PLOTË), TIRANË"**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 2, 43, 44, 44/1 dhe 45, të ligjit nr. 9741, datë 21.5.2007, "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Arsimit dhe Sportit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në pikën 1, të vendimit nr. 286, datë 6.4.2011, të Këshillit të Ministrave, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

"Leja për hapjen e kësaj shkolle i jepet "Komunitetit Mysliman Shqiptar".

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Edi Rama**

**VENDIM**
**Nr. 572, datë 24.6.2015**

**PËR MIRATIMIN E STANDARDEVE TË SHËRBIMEVE NË QENDRËN KOMBËTARE TRANSITORE TË EMERGJENCËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 18, të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e standardeve të shërbimeve në Qendrën Kombëtare Transitore të Emergjencës, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Shëndetësisë dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Edi Rama**

STANDARDET E OFRIMIT TË SHËRBIMEVE NË QENDRËN KOMBËTARE TRANSITORE TË EMERGJENCËS

**Hyrje dhe përmbajtja**

Hartimi i standardeve të shërbimeve të emergjencës në Qendrën Kombëtare Transitore të Emergjencës shënon një hap të rëndësishëm në garantimin dhe në zhvillimin e mëtejshëm të të drejtave të njeriut të sanksionuara në Kushtetutë, në legjislacionin shqiptar dhe në konventat ndërkombëtare, të ratifikuara nga qeveria shqiptare, si Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Njeriut.

Në zbatim të vendimit nr. 582, datë 10.9.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për një ndryshim në vendimin nr. 864, datë 27.9.2013, të Këshillit të Ministrave, "Për kalimin në përgjegjësi administrimi, nga Ministria e Mbrojtjes te Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, të disa objekteve dhe truallit funksional, pjesë e pronës nr. 84, me emërtim "Ish-regjimenti i kimisë", me vendndodhje në Shtish-Tufinë, Tiranë, dhe për një ndryshim në vendimin nr. 515, datë 18.7.2003, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e listës së inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore, të cilat i kalojnë në përgjegjësi administrimi Ministrisë së Mbrojtjes, të ndryshuar", është përcaktuar godina për ngritjen e Qendrës Kombëtare Transitore të Emergjencës.

Ndërsa në zbatim të nenit 8, të ligjit nr. 90/2012, "Për organizimin dhe funksionimin e administratës shtetërore", dhe të ligjit nr. 9355/2006, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar, urdhrit nr. 195, datë 15.10.2014, të ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, "Për ngritjen dhe funksionimin e Qendrës Kombëtare Transitore të Emergjencës", si dhe të urdhrit nr. 32, datë 5.3.2015, të Kryeministrit, "Për

disa ndryshime në urdhrin nr. 88, datë 25.10.2011, të Kryeministrit, "Për miratimin e strukturës dhe organikës së Shërbimit Social Shtetëror", të ndryshuar, është ngritur dhe funksionin Qendra Kombëtare Transitore e Emergjencës, në varësi administrative të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit Social Shtetëror.

Hartimi dhe implementimi i paketës së standardeve të shërbimeve të emergjencës në QKTE është në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me standardet e kërkuara ndërkombëtare, që përbën një hap të rëndësishëm në procesin e integrimit të vendit tonë në Bashkimin Evropian.

Këto standarde do të ofrohen në situatat e emergjencës kur familjet nuk janë në gjendje të sigurojnë jetesën e tyre dhe të jenë të pavarura, në situata kur familjet (dhe personat më të cenueshëm dhe të vetmuar, si të moshuarit apo personat me aftësi të kufizuara) mund të kenë nevojë për ndihmë apo mbështetje emergjence. Ato familje, që kanë veçanërisht nevojë për mbështetje urgjente dhe strehim, janë ato që mbeten të pastrehë dhe detyrohen të jetojnë në rrugë.

Hartimi i këtyre standardeve për shërbimet e emergjencës në QKTE është i rëndësishëm për disa arsye:

- Për të garantuar cilësinë e shërbimeve për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut, të sanksionuara në legjislacionin në fuqi.

- Për respektimin e parimeve, si: respektimi dhe garantimi i vlerave dhe i personalitetit të individit; universaliteti; barazia e mundësive; e drejta për të përfituar; partneriteti; transparenca dhe paanshmëria; mosdiskriminimi; pavarësia, integrimi shoqëror dhe pjesëmarrja në jetën e komunitetit.

- Vendosja e standardeve për shërbimin e emergjencës në Qendër do të shërbejë si detyrim ligjor ndaj strukturave në nivel qendror dhe vendor për të matur dhe për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve për mbrojtjen e të drejtave të njeriut brenda territorit të tyre. Në kushtet e zhvillimit del e nevojshme që shteti të vendosë disa rregulla dhe standarde për cilësinë e shërbimeve që duhen respektuar nga të gjitha institucionet në nivel qendror dhe vendor.

Ky set standardesh i shërbimeve të emergjencës ngarkon me përgjegjësi edhe autoritetet vendore. Vendosja e standardeve do t'i ndihmojë ata në përmbushjen e funksioneve të reja në lidhje me shërbimet e integruara për plotësimin e nevojave emergjente sociale të komunitetit, ku ata ushtrojnë autoritetin e tyre. Këto funksione lidhen me planifikimin, sigurimin e shërbimeve për mbështetjen e familjeve, si dhe zhvillimin e rrjeteve të bashkëpunimit rajonal apo lokal.

**Shtrirja dhe baza e standardeve**

Standardet janë bazuar në ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar, dhe te praktika e punës e ndjekur në Qendrën Kombëtare Transitore të Emergjencës, te përvoja e personave që punojnë në qendër, si dhe te diskutimet me Ministrinë e Mirëqenies Sociale për sa i përket zhvillimit të këtyre shërbime vënë një të ardhme më të largët.

Standardet, duke pasur parasysh fazën e këtyre zhvillimeve në Shqipëri, janë bërë qëllimisht sa më të qarta dhe të thjeshta, të pangarkuara me hollësi, por të fokusuara te pikat kryesore. Kjo është përpjekja e parë për të hartuar standarde, prandaj është e rëndësishme të jemi realistë mbi ato që janë të mundura për t'u arrirë.

**Formati i standardeve**

Standardet janë bazuar mbi pesë fusha specifike, por që lidhen me njëra-tjetrën. Krahas identifikimit të kritereve për çdo standard, janë përfshirë edhe shembuj treguesish që të ndihmojnë për të vlerësuar a është plotësuar një standard i caktuar. Është gjetur edhe metoda për mbledhjen e informacionit për të ndihmuar vlerësimin.

Standardet, gjithashtu, do të shërbejnë si dokument bazë:

i) për Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë për të vlerësuar ofrimin e shërbimeve të emergjencës dhe mbështetjes së familjeve e të individëve në situata emergjente;

ii) për strukturat e Inspektoratit të Punës dhe të Shërbimit Social, të cilat do të kontrollojnë cilësinë e shërbimeve;

iii) për organizatat që përfaqësojnë dhe mbrojnë të drejtat e njeriut për të vlerësuar situatën e ofrimit të shërbimit të emergjencës dhe realizimin e të drejtave të tyre;

iv) për institucionet akademike dhe organizatat e përfshira në veprimtari arsimore e trajnuese apo studiuesit e fushës etj;

v) për vetëvlerësimin e punës dhe për raportimin te Shërbimi Social Shtetëror.

Krahas kësaj, standardet mund të përdoren për të krijuar njësi matëse për praktikën dhe për të identifikuar fushat ku ka nevojë për përmirësim, si

për advokacinë, ashtu edhe për nxitjen e përmirësimit të shërbimeve.

Kjo bën që standardet të mos shikohen më si thjesht 'pajtim' me politikat, por të jenë të dobishme për të zhvilluar edhe më tej praktikën.

Standardi 1. Mjedisi dhe kushtet për ofrimin e shërbimeve

Rezultati përfundimtar i dëshiruar:

Përfituesi i shërbimeve merr shërbime në kushte dhe në një mjedis të përshtatshëm.

Standardi 1:

Qendra Kombëtare Transitore e Emergjencës siguron kushte dhe mjedis të përshtatshëm për përfituesit dhe për stafin në përputhje me kapacitetin, karakterin e shërbimeve dhe nevojat e emergjente të përfituesve.

Treguesit:

1.1 Qendra siguron mjedis fizik të përshtatshëm, mikpritës, të një stili shtëpiak dhe të një cilësie të mirë për fëmijët, prindërit apo personat e tjerë në nevojë, në përputhje me nevojat emergjente të tyre.

1.2 Qendra krijon mjedise të përshtatshme, private për higjienën personale dhe përgatitjen e vakteve ushqimore.

1.3 Qendra siguron furnizimin e përshtatshëm me ujë të rrjedhshëm, energji elektrike dhe gaz.

1.4 Qendra ofron mirëmbajtje e siguri të ambienteve të jashtme dhe ato të komunitetit.

1.5 Qendra mundëson marrjen e shërbimeve publike të familjeve/individëve në nevojë në Komunitetin vendor ku është e vendosur.

Standardi 2: Paketa e plotë e shërbimeve të përkujdesjes sociale për të përballuar situatën e emergjencës drejt integrimit të tyre në shoqëri.

Rezultati përfundimtar i dëshiruar 2:

Shërbimet e ofruara nga Qendra Kombëtare Transitore e Emergjencës plotësojnë nevojat emergjente individuale të përfituesve dhe mundësojnë përgatitjen për jetesën e tyre të pavarur.

Standardi 2:

Qendra Kombëtare Transitore e Emergjencës ofron një paketë të plotë dhe eficiente shërbimesh, në përputhje me nevojat komplekse të përfituesve, në bashkëpunim me institucione të tjera të drejtpërdrejta në shërbime (arsim, punësim, shëndetësi etj.) në nivel qendror dhe vendor për të mundësuar aftësinë e jetës së tyre të pavarur në të ardhmen.

Treguesit:

2.1 Qendra (QKTE) ofron shërbime të specializuara ligjore për t'iu mundësuar përfituesve aksesin te shërbimet e tjera publike.

2.2 Qendra (QKTE) siguron ofrimin e një game të gjerë shërbimesh sociale integruese për t'i drejtuar përfituesit në përgatitjen e jetës së pavarur.

2.3 Qendra (QKTE) siguron përfshirjen e përfituesve në marrjen e shërbimeve bazë (shëndetësore, arsimore, transport publik etj.).

2.4 Qendra (QKTE) mundëson mbështetjen e përfituesve që të jenë të pavarur ekonomikisht dhe të sigurojnë një akomodim alternativ.

2.5 Qendra ofron shërbime për të garantuar mosshpërbërjen e familjes, duke pasur në fokus interesin më të lartë të fëmijës dhe të drejtat e anëtarëve të tjerë të familjes.

Standardi 3: Menaxhimi i procedurave të shërbimit në mënyrë sistematike dhe të vazhdueshme.

Rezultati përfundimtar i dëshiruar 3:

Nëpërmjet menaxhimit të procedurave të rregullta të vlerësimit, planifikimit, referimit dhe dhënies së shërbimeve, Qendra Kombëtare Transitore e Emergjencës siguron shërbime eficiente për përfituesin, duke arritur qëllimin, objektivat, aktivitetet, vlerat dhe parimet e saj. Këto procese janë multidisiplinare dhe realizohen nëpërmjet një rrjeti bashkëpunimi, i cili përfshin subjekte të ndryshme publike dhe jopublike.

Standardi 3: Qendra Kombëtare Transitore e Emergjencës ka procedura të qarta të vlerësimit, planifikimit, referimit dhe dhënies së shërbimeve të përfituesve, të cilat tregojnë realizimin e qëllimit, objektivave dhe aktiviteteve të qendrës.

Treguesit:

3.1 Qendra siguron staf të kualifikuar për të ndjekur vazhdimësinë e shërbimeve për familjet/përfituesit e saj, ku për çdo përfitues është caktuar një punonjës.

3.2 Qendra, nëpërmjet stafit, informon dhe nënshkruan kontratën me familjen/individët e akomoduar në të brenda 24 orësh.

3.3 Vlerësimi i nevojave të familjeve / përfituesve dhe hartimi i plani të përkujdesjes për të gjithë banorët brenda 5 ditësh nga dita e pranimit nga stafi i qendrës.

3.4 Zbatimi i planit të përkujdesjes ndiqet në mënyrë proaktive dhe në kohën e duhur.

3.5 Rishikohet rregullisht plani i përkujdesjes.

3.6 Qendra (QKTE) ofron shërbimet në përputhje me nevojat e familjeve/përfituesve për një afat të shkurtër dhe të përkohshëm.

3.7 Familjet/përfituesit kanë dosjet personale të tyre të përditësuara dhe të sigurta për ruajtjen e konfidencialitetit.

3.8 Intervistat, takimet dhe telefonatat bëhen në mënyrë private për të garantuar konfidencialitetin.

3.9 Raportimi për zbatimin e planit të përkujdesjes së përfituesve hartohet në përputhje me afatet kohore të përcaktuara në planin e përkujdesjes.

3.10 Qendra harton dhe miraton rregulloren e brendshme të organizimit e të funksionimit të saj, ku parashikohen të drejtat dhe detyrimet e stafit/përfituesve, kodi i sjelljes etj.

Standardi 4: Siguria dhe trajtimi i barabartë i përfituesve pavarësisht nevojave të tyre.

Rezultati përfundimtar 4: Të gjithë përfituesve u garantohet siguria e jetës nga stafi i kualifikuar dhe ata trajtohen me barazi, pa diskriminim dhe privilegje të pamerituara.

Standardi 4: Qendra Kombëtare Transitore e Emergjencës ka masa specifike për të garantuar sigurinë e përfituesve, si edhe procedura monitorimi për zbatimin e tyre.

Treguesit:

4.1 QKTE-ja disponon librin për vizitorët të cilët kanë hyrë në qendër.

4.2 Qendra disponon procedura dhe dokumentacione të cilat vërtetojnë monitorimin periodik për identifikimin e problemeve të mirëmbajtjes apo të sigurisë.

4.3 Qendra disponon dosjet e stafit ose kopjen e dosjes së stafit, të cilat tregojnë rekrutimin, kualifikimin dhe performancën e stafit në përputhje me strukturën e miratuar.

4.4 Vlerësimi i rrezikut bëhet para veprimtarive dhe merret miratimi nga të rriturit dhe fëmijët.

4.5 Qendra disponon staf dhe procedura konkrete për mbikëqyrjen e fëmijëve gjatë gjithë kohës.

4.6 Qendra disponon të gjitha mjetet e domosdoshme dhe staf të kualifikuar në rastet e emergjencave.

4.7 Qendra në rastet e identifikimit të cenimit të të drejtave të fëmijëve bashkëpunon dhe me Njësinë për Mbrojtjen e Fëmijëve (NJMF) të njësisë përkatëse.

Standardi 5: Pjesëmarrja e përfituesve në vendimmarrje.

Rezultati përfundimtar i dëshiruar: Përfshirja dhe pjesëmarrja e përfituesve gjatë gjithë procesit të ofrimit të shërbimeve në Qendrën Kombëtare Transitore të Emergjencës.

Standardi 5: Përfshirja e fëmijës dhe familjes në mënyrë aktive dhe të plotë gjatë ofrimit të shërbimeve në qendër.

Treguesit:

5.1 Përfituesit, përfshirë edhe fëmijët, marrin informacionin e mjaftueshëm për të marrë pjesë në mënyrë aktive dhe të sigurt te procesi i vendimmarrjes.

5.2 Përfituesit informohen mbi shërbimet që ofrohen në qendër dhe shërbimet e tjera publike jashtë qendrës, përfshirë shërbimet për mbrojtjen e fëmijëve dhe ku mund të shkojnë për të kërkuar mbështetje.

5.3 Përfituesve u kërkohet në mënyrë aktive mendimi i tyre, i cili merret në konsideratë gjatë marrjes së vendimeve për funksionimin e qendrës dhe programit vjetor.

5.4 Nënshkrimi i marrëveshjeve me shkrim dhe programeve të punës të miratuara nga përfituesit/fëmijët.

5.5 Qendra disponon procedura të cilat mundësojnë të drejtën e ankimimit të tyre, përfshirë edhe fëmijët.

**Standardet&Kriteret**
**Standardi 1: Mjedisi dhe kushtet për ofrimin e shërbimeve në Qendrën Kombëtare Transitore të Emergjencës**

Standadi 1: Qendra Kombëtare Transitore e Emergjencës siguron kushte dhe mjedis të përshtatshëm për përfituesit dhe për stafin në përputhje me kapacitetin, karakterin e shërbimeve dhe nevojat e emergjente të përfituesve.

| **STANDARDI 1: MJEDISI FIZIK** | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Ref** | **Kriteret** | **Plot.** | **Plot. Pjes.** | **Nuk është plot.** | **N/A** | **Komente / Rekomandime** |
| 1.1 | **Qendra siguron mjedis fizik të përshtatshëm, mikpritës, të një stili shtëpiak dhe të një cilësie të mirë për fëmijët, prindërit apo personat e tjerë në nevojë, në përputhje me nevojat e tyre emergjente.** | | | | | |
| | Matja: *Vëzhgimi* | | | | | |
| | Tregues:<br>• *Familjet/individët në nevojë akomodohen në një ambient të mbyllur me çelës për të vendosur sendet e tyre në një vend të sigurt.*<br>• *Në çdo njësi/ndarje vendoset vetëm një familje/individë në nevojë.*<br>• *Ambientet janë të pastra, të thata dhe të ngrohta, nuk kanë lagështirë dhe në gjendje të mirë.*<br>• *Dritaret dhe dyert mund të mbyllen normalisht.*<br>• *Orenditë shtëpiake, mobiljet dhe pajisje të tjera shtëpiakeu jepen hua atyre që nuk i kanë p.sh, krevatet, tavolinat, karriket dhe batanijet, çarcafë etj.* | | | | | |
| 1.2 | **Qendra krjion mjedise të përshtatshme private për higjienën personale dhe përgatitjen e vakteve ushqimore.** | | | | | |
| | Matja:*Vëzhgimi* | | | | | |

| STANDARDI 1: MJEDISI FIZIK | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Ref** | **Kriteret** | **Plot.** | **Plot. Pjes.** | **Nuk është plot.** | **N/A** | **Komente / Rekomandime** |
| | Tregues:<br>• *Çdo njësi/ndarje ka ambiente gatimi dhe larjeje ose,nëse janë të përbashkëta, ato janë të pastra, të sigurta dhe mund t'i përdorin të gjithë.*<br>• *Ambientet e higjienës personale dhe tualetet qëjanë të përbashkëta ndahen sipas gjinisë.*<br>• *Numri i përshtatshëm i tualeteve dhe lavamanëve në raste kur janë të përbashkëta.*<br>• *Praktikat kryesore të mirëmbajtes së higjienës të shkruara në gjuhë të thjeshtëe të kuptueshme dhe të vendosuara në vende të dukshme.*<br>• *Pajisja me enë kuzhine dhe gatimi, nëse është e nevojshme nga qendra.* | | | | | |
| 1.3 | **Qendra siguron furnizimin e përshtatshëm me ujë të rrjedhshëm, energji elektrike dhe gaz.** | | | | | |
| | Matja: *Vëzhgimidhe rishikimi i inspektimeve /riparimeve* | | | | | |
| | *Tregues:*<br>• *Programe inspektimi 6-mujore mbi shërbimin e furnizimit me ujë, gaz për të garantuar sigurinë e tyre.*<br>• *Kontrata të rregullta me ofruesit e shërbimeve të energjisë, ujit dhe gazit ku përcaktohen qartë të drejtat dhe detyrimet.*<br>• *Rrjetet e instaluara të energjisë elektrike, ujësjellësit, kanalizimeve dhe gazit të jenësipas standardeve teknike, të miratura nga organet kompetente.*<br>• *Problemet e identifikuara në këto shërbime duhet t'i* | | | | | |

| STANDARDI 1: MJEDISI FIZIK | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Ref** | **Kriteret** | **Plot.** | **Plot. Pjes.** | **Nuk është plot.** | **N/A** | **Komente / Rekomandime** |
| | *raportohen pa vonesë kompanisë që ofron shërbimin.*<br>• *Shërbimet e furnizimit me energji, gaz, ujëinspektohen rregullisht për sigurinë menjëherë pasiështë larguar familja/individi në nevojë dhe aty transferohet një tjetër.*<br>• *Praktikat kryesore të standardizuara të mirëmbajtjes dhe kujdesit të jetës, të shkruara në gjuhë të thjeshtë dhe të kuptueshme, të vendosen pranë çdo njësie/ndarjeje.* | | | | | |
| 1.4 | **Ambientet e jashtme dhe ato të komunitetit (si shkallët) janë të pastra dhe të sigurta** | | | | | |
| | Matja: *Vëzhgimi* | | | | | |
| | Tregues:<br>• *Ambientet e jashtme të përbashkëta janë të pastra, pa mbeturina apo mbetje, si gurë, xhama etj.*<br>• *Sigurohet ndriçim i mjaftueshëm që të mos ketë zona pa ndriçim, që mund të jenë kërcënim për sigurinë.*<br>• *Pajisjet te këndi i lojërave janë të mirëmbajtura.*<br>• *Bimët e mbjella në kopsht nuk do të kenë përmbajtje helmuese dhe të rrezikshme për fëmijët.*<br>• *Krijimi i ambienteve rekreative në përputhje me moshën e fëmijëve përfitues të qendrës.*<br>• *Rregulla të qarta dhe të vendosura në ambiente të dukshme për mirëmbjatjen e tyre.* | | | | | |
| 1.5 | **Qendra (QKTE) mundëson marrjen e shërbimeve publike të familjeve/individëve në nevojë në komunitetin lokal kuështëvendosur**. | | | | | |
| | Matja: *Vëzhgimi*dhe diskutimi me banorët | | | | | |
| | Tregues: | | | | | |

| STANDARDI 1: MJEDISI FIZIK | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Ref** | **Kriteret** | **Plot.** | **Plot. Pjes.** | **Nuk është plot.** | **N/A** | **Komente / Rekomandime** |
| | • *Qendra Kombëtare Transitore e Emergjencësështë e lokalizuar pranë komuniteteve lokale.*<br>• *Qendra Kombëtare Transitore e Emergjencës kaafër institucione të cilat ofrojnë shërbime publike të drejtpërdrejta të tilla, si: edukimi arsimor i fëmijëve, shërbimi i transportit, shërbimi shëndetësor, strehimi, përfshirja në programet e mbrojtjes sociale etj.*<br>• *Qendra Kombëtare Transitore e Emergjencës nuk mund të ketë më shumë se 30 ambiente banimi. (për të mos e kthyer në një 'geto' dhe për të inkurajuar pjesëmarrjen në komunitet)* | | | | | |

**Standardi 2: Paketa e plotë e shërbimeve të përkujdesjes sociale për të përballuar situatën e emergjencës drejt integrimit të tyre në shoqëri.**

**Standardi 2.** Qendra Kombëtare Transitore e Emergjencës ofron një paketë të plotë dhe efiçente shërbimesh, në përputhje me nevojat komplekse të përfituesve, në bashkëpunim me institucione të tjera të drejtpërdrejta në shërbime (arsim, punësim, shëndetësi etj) në nivel qendror dhe vendor për tëmundësuar aftësinë e jetës së tyre të pavarur në të ardhmen.

| **STANDARDI 2: PAKETA E PLOTË E SHËRBIMEVE TË PËRKUJDESJES SOCIALE** | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Ref** | **Kritere** | **Plot.** | **Plot. Pjes.** | **Nuk është plot.** | **N/A** | **Komente / Rekomandime** |
| 2.1. | **Qendra (QKTE) ofron shërbime të specializuara ligjore për t'u mundësuar përfituesve aksesin te shërbimet e tjera pubilike.** | | | | | |
| | Matja:*Diskutim me banorët dhe inspektimi i 10 dosjeve të përzgjedhura rastësisht.* | | | | | |
| | Tregues:<br>• *Mbështeten prindërit që të marrin dokumentet e regjistrimit të lindjes;*<br>• *Mbështetje ligjore, për shembull, në rast mosmarrëveshjesh apo për rastet e dhunës në familje.* | | | | | |
| 2.2. | **Qendra (QKTE) siguron ofrimin e një game të gjerë shërbimesh sociale integruese për t'i drejtuar përfituesit në përgatitjen e jetës së pavarur.** | | | | | |
| | Matja: *Diskutim me banorët dhe stafin* | | | | | |
| | Tregues:<br>• *Programi i punës njëvjeçar i miratuar, ku përfshihen shërbimet sociale integruese, si (këshillim, programe prindërimi, grupe mbështetëse dhe aktivitete për fëmijët, informimi etj).*<br>• *Marrëveshje bashkëpunimi me aktorë publikë dhe* | | | | | |

| STANDARDI 2: PAKETA E PLOTË E SHËRBIMEVE TË PËRKUJDESJES SOCIALE | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Ref** | **Kritere** | **Plot.** | **Plot. Pjes.** | **Nuk është plot.** | **N/A** | **Komente / Rekomandime** |
| | *privatëpër ofrimin e programeve të specializuara, për shembull, për abuzimin me drogën, alkoolin, formimin profesional etj).*<br>• *Qendra, nëpërmjet stafit, informon përfituesit mbi programet mbështetëse dhe garanton përfshrijen e tyre nëse ata janë të interesuar.* | | | | | |
| 2.3. | **Qendra (QKTE) siguron përfshrijen e përfituesve në marrjen e shërbimeve bazë (shëndetësore, arsimore, transport publik etj).** | | | | | |
| | Matja: *Inspektimi i 10 dosjeve të përzgjedhura rastësisht dhe diskutimi me banorët e me stafin.* | | | | | |
| | Tregues:<br>• *Fëmijët regjistrohen në shkolla publike afër komuntietit ku jetojnë.*<br>• *Përfituesit e qendrës janë të pajisur me libreza shëndetësore/kartë shëndeti të cilat mundësojnë marrjen e shërbimit shëndetësor në komunitetitn ku jetojnë.*<br>• *Në rastet kur është e nevojshme ofrohen shërbimet e posaçme shëndetësore, si në rast shtatzënie apo problemeve të shëndetit mendor etj.* | | | | | |
| 2.4. | **Qendra (QKTE) mundëson mbështetjen e përfituesve që të jenë të pavarur ekonomikisht dhe të sigurojnë një akomodim alternativ.** | | | | | |
| | Matja:*Inspektimi i 10 dosjeve të përzgjedhura rastësisht dhe diskutimi me banorët dhe me stafin.* | | | | | |
| | Tregues:<br>• *Përfshrija e përfituesve të Qendrës (Familjet/indivdët në nevojë)në programin e ndihmës ekonomike nëse plotësojnë* | | | | | |

| STANDARDI 2: PAKETA E PLOTË E SHËRBIMEVE TË PËRKUJDESJES SOCIALE | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Ref** | **Kritere** | **Plot.** | **Plot. Pjes.** | **Nuk është plot.** | **N/A** | **Komente / Rekomandime** |
| | *kushtet.*<br>• *Informimi dhe përfshirja e përfituesve të Qendrës (i individëve në moshë pune) në programet e punësimit dhe formimit profesional.*<br>• *Bëhen referime tek autoritetet për akomodim alternativ (ku mund të vendosen pasi dalin nga qendra).*<br>• *Familjet/banorët mbështeten që të identifikojnë mënyra të tjera jetese, si ambiente private me qira etj.* | | | | | |
| 2.5. | **Qendra ofron shërbime për të garantuar mosshpërbërjen e familjes duke pasur në fokus interesin më të lartë të fëmijës dhe të drejtat e anëtarëve të tjerë të familjes.** | | | | | |
| | Matja:*Inspektimi i 10 dosjeve të përzgjedhura rastësisht dhe diskutimi me banorët dhe me stafin.* | | | | | |
| | Tregues:<br>• *Qendra disponon dosjet qëtregojnë se plani i përkujdesjes sociale të familjeve/indivdëve në nevojëpërfshin shërbime të cilat mbulojnë nevojat bazë, si arsimi, shëndeti etj. dhe shërbime të tjera mbështetëse (si këshillim etj.)*<br>• *Qendra ofron shërbime për të mbështetur prindërit që të marrin përsipër përgjegjësinë për fëmijët e tyre dhe të ofrojnë kujdesin e nevojshëm.* | | | | | |

**Standardi 3: Menaxhimi i procedurave të shërbimit në mënyrë sistematike dhe të vazhdueshme.**

**Standardi 3:**Qendra Kombëtare Transitore e Emergjencës ka procedura të qarta të vlerësimit, planifikimit, referimit dhe dhënies së shërbimeve të përfituesve të cilat tregojnë realizimin e qëllimit, objektivave dhe aktiviteteve të qendrës.

| **STANDARDI 3: SISTEME & PROCEDURA** | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Ref** | **Kritere** | **Plot.** | **Plot. Pjes.** | **Nuk është plot.** | **N/A** | **Komente / Rekomandime** |
| 3.1. | **Qendra siguron staf të kualifikuar për të ndjekur vazhdimësinë e shërbimeve për familjet/përfituesit e saj ku për çdo përfitues është caktuar një punonjës.** | | | | | |
| | Matja: *Diskutim me stafin e qendrës dhe banorët* | | | | | |
| | Tregues:<br>• *Të gjitha rastet kanë një punonjës kyç (si punonjës social ose pjesëtar stafi të qendrës) qëështë caktuar për dosjen e tyre.*<br>• *Plani i veprimit ka përfshirë mbështetjen dhe asistencën qëpërgatitet në bashkëpunim me familjen/banorin për të cilin përgatitet dosja.* | | | | | |
| 3.2. | **Qendra, nëpërmjet stafit, informon dhe nënshkruan kontratën me familjen/individët që akomodohen në të brenda 24 orësh.** | | | | | |
| | Matja: *Inspektimi i 10 dosjeve të përzgjedhura rastësisht* | | | | | |
| | Tregues:<br>• *Përfituesit e qendrës kanë nënshkruar kantratën me shkrim ndërmjet qendrës dhe përfituesit. Një kopje e disponon përfituesi dhe një kopje vendoset në dosjen e përfituesit.*<br>• *Kontrata me shkrim parashikon sjelljen që duhet të kenë banorët, përfshirë mbikëqyrjen e fëmijëve dhe përgjegjësitë kryesore të stafit (detyrat dhe të drejtat* | | | | | |

| STANDARDI 3: SISTEME & PROCEDURA | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Ref** | **Kritere** | **Plot.** | **Plot. Pjes.** | **Nuk është plot.** | **N/A** | **Komente / Rekomandime** |
| | *epalëve).* | | | | | |
| 3.3. | **Vlerësimi i nevojave të familjeve/përfituesve dhe hartimi i planit të përkujdesjes për të gjithë banorët brenda 5 ditësh nga dita e pranimit nga stafi i qendrës.** | | | | | |
| | Matja:*Inspektimi i 10 dosjeve të përzgjedhura rastësisht dhe diskutimi me banorët dhe me stafin.* | | | | | |
| | Tregues:<br>• *Dosjet e përfituesve përmbajnë formularin e plotësuar të vlerësimit (nga të gjitha dimensionet) dhe planin e përkujdesjessociale të firmosur nga punonjësi i rastit dhe përfituesi.*<br>• *Plani i përkujdesjes identifikon dhe punonjësin e rastit.*<br>• *Plani i përkujdesjes përcakton shërbimet që do të oforhen me afate kohore të përcaktuara.*<br>• *Plani i përkujdesjes përcakton afatin e qëndrimit të banorëve te Qendra e Emergjencës.* | | | | | |
| 3.4. | **Zbatimi i planit të përkujdesjes ndiqet në mënyrë proaktive dhe në kohën e duhur** | | | | | |
| | Matja:*Inspektimi i 10 dosjeve të përzgjedhura rastësisht* | | | | | |
| | Tregues:<br>• *Dosja përmban telefonatat/takimet që vërtetojnë se plani i përkujdesjesështë ndjekur, psh. telefonata me agjencitë e tjera dhe referimet e dokumente të tjera të cilat vërtetojnë ofrimin e shërbimeve nëse janë të disponueshme.* | | | | | |
| 3.5. | **Rishikohet rregullisht plani i përkujdesjes** | | | | | |
| | Matja:*Inspektimi i 10 dosjeve të përzgjedhura rastësisht* | | | | | |
| | Tregues: | | | | | |

| STANDARDI 3: SISTEME & PROCEDURA | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Ref** | **Kritere** | **Plot.** | **Plot. Pjes.** | **Nuk është plot.** | **N/A** | **Komente / Rekomandime** |
| | • *Dosjet përmbajnë rishikimet e planit tëpërkujdesjes që bëhen të paktën çdo muaj.*<br>• *Shënimet e dokumentuara/konfirmimi i diskutimeve që janë bërë gjatë takimeve për rishikimin e planit të përkujdesjes dhe planit të rishikuar futen në dosje.* | | | | | |
| 3.6. | **Qendra (QKTE) ofron shërbimet në përputhje me nevojat e familjeve/përfituesve për një afat të shkurtër dhe të përkohshëm.** | | | | | |
| | Matja:*Inspektimi i 10 dosjeve të përzgjedhura rastësisht dhe 5 dosjeve, për të cilat është mbyllur rasti dhe diskutimi me stafin.* | | | | | |
| | Tregues:<br>• *Përfituesit akomodohen si rezultat i të qenit të pastrehë.*<br>• *Qëndrimi maksimal i banorëve është 3-6 muaj.*<br>• *Në rast se banorët do të qëndrojnë më shumë se 6 muaj, kjo duhet të dokumentohet qartë dhe do të ndodhë vetëm në raste të rralla (për shembull, për shkak të nevojave specifike, si aftësi të kufizuara, pamundësi).* | | | | | |
| 3.7. | **Familjet/përfituesit kanë dosjet personale të tyre të përditësuara dhe të sigurta për ruajtjen e konfidencialitetit** | | | | | |
| | Matja: *Inspektimi pamor& diskutimi me stafin* | | | | | |
| | Tregues:<br>• *Përgatitet dosja për çdo përfitues.*<br>• *Ka dollap ose rafte të mbyllura me çelës për të vendosur dosjet.*<br>• *Dollapi/rafti/zyra mbahet gjithë kohën e mbyllur me* | | | | | |

| STANDARDI 3: SISTEME & PROCEDURA | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Ref** | **Kritere** | **Plot.** | **Plot. Pjes.** | **Nuk është plot.** | **N/A** | **Komente / Rekomandime** |
| | *çelës,përveç rasteve kurështë stafi në zyrë.*<br>• *Çelësin e dollapit/raftit/zyrës e mban vetëm stafi.*<br>• *Nuk mbahen mbi tavolinë dokumente për rastin/dosjet, përveç rasteve kur po përdoren dhe i gjithë informacioni për banorët është i futur në dosje.*<br>• *Ambiente për të eliminuar dokumentet/shënimet në mënyrë të sigurt (p.sh. makinë grirëse (shredder)).* | | | | | |
| 3.8. | **Intervistat, takimet dhe telefonatat bëhen në mënyrë private për të garantuar konfidencialitetin** | | | | | |
| | Matja:*Inspektim pamor* | | | | | |
| | Tregues:<br>*Zyra të veçanta ku përfituesit realizojnë shërbimet e këshillimit, intervisat etj.*<br>• *Zyrat kanëkomoditetitn e duhur për të krijuar atmosferë të ngrohtë për të realizuar shërbimet e këshillimit, intervistat sipas standardeve të përgjithshme.* | | | | | |
| 3.9. | **Raportimi mbi zbatimin e planit të përkujdesjes së përfituesve hartohet në përputhje me afatet kohore të përcaktuara në planin e përkujdesjes.** | | | | | |
| | Matja: *Inspektimi i dokumenteve, diskutimi me stafin/ Inspektoratin* | | | | | |
| | Tregues:<br>• *Dosjet e përfituesve.* | | | | | |
| 3.10. | **Qendra harton dhe miraton rregulloren e brendshme të organizimit dhe funksionimit të saj, ku parashikohen të drejtat dhe detyrimet e stafit/përfituesve, kodi i sjelljes etj.** | | | | | |

| STANDARDI 3: SISTEME & PROCEDURA | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Ref** | **Kritere** | **Plot.** | **Plot. Pjes.** | **Nuk është plot.** | **N/A** | **Komente / Rekomandime** |
| | | | | | | |
| | Matja: *Diskutim me stafin* | | | | | |
| | Tregues:<br>• Rregullorja e QKTE-së<br>Rrregullorja e afishuar | | | | | |

**Standardi4: Siguria dhe trajtimi i barabartë i përfituesve pavarësisht nevojave të tyre.**

**Standardi 4: :** Qendra Kombëtare Transitore e Emergjencës ka masa specifike për të garantuar sigurinë e përfituesve si edhe procedura monitorimi për zbatimin e tyre.

| **STANDARDI 4: SIGURIA&MBROJTJA** | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Ref** | **Kritere** | **Plot.** | **Plot. Pjes.** | **Nuk është plot.** | **N/A** | **Komente / Rekomandime** |
| 4.1 | **QKTE-ja disponon librin për vizitorët të cilët kanë hyrë në Qendër** | | | | | |
| | Matja: *Inspektimi i dokumenteve* | | | | | |
| | Tregues<br>• Të gjithë vizitorët, përfshirë ata që vijnë për takime zyrtare apo vizitorë të tjerë, hidhen te një regjistër ditor. | | | | | |
| 4.2 | **Qendra disponon procedura dhe dokumetacione të cilat vërtetojnë monitorimin periodik për identifikimin e problemeve për mirëmbajtjen apo sigurinë.** | | | | | |
| | Matja: *Inspektimi i dokumenteve, diskutimi me stafin* | | | | | |
| | Tregues:<br>• *Dokumentimi i monitorimeve të rregullta javore të ndërtesave (ambientet e jashtme dhe ato të përbashkëta) për të kontrolluar sigurinë (tëmos ketë mbeturina, a funksionojnë dritat etj.).*<br>• *Kërkesat e dokumentuara/bëhet konfirmimi i mirëmbajtjes.* | | | | | |
| 4.3 | • *Qendra disponon dosjet e stafit ose kopjen e tyre të cilat tregojnë rekrutimin, kualifikimin dhe performancën e stafit në përputhje me strukturën e miratuar.* | | | | | |
| | *Matja: Inspektimi i dosjeve, diskutimi me stafin* | | | | | |
| | • *Tregues* | | | | | |

| STANDARDI 4: SIGURIA&MBROJTJA | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Ref** | **Kritere** | **Plot.** | **Plot. Pjes.** | **Nuk është plot.** | **N/A** | **Komente / Rekomandime** |
| | • *Dosjet e stafit me të gjitha elementet përbërëse sipas legjislacionit në fuqi.*<br>• *Stafi ka kualifikime për të punuar me fëmijët dhe familjet si dhe të rriturit vulnerabël ose të paktën tre vjet përvojë pune me persona që kanë nevojë për asistencë.*<br>• *Stafit i bëhet vlerësim dhe kontrollohet për t'u siguruar se nuk kanë precedentë penalë dhe se janë të përshtatshëm për të punuar me fëmijët dhe të rriturit vulnerabël.*<br>• *Të gjithë stafit i bëhet trajnim për ta ndërgjegjësuar për mbrojtjen e fëmijëve.*<br>• *Stafi e di se ku të referojë një rast që paraqet shqetësim për mbrojtjen e fëmijës.* | | | | | |
| 4.4 | **Vlerësimi rrezikut bëhet para veprimtarive dhe merret miratimi nga të rriturit dhe fëmijët** | | | | | |
| | Matja:*Inspektimi i dokumentacionit* | | | | | |
| | Tregues:<br>• Kopje të vlerësimit të rrezikut dhe formularët e aprovimit në dosje. | | | | | |
| 4.5 | Qendra disponon staf të kualifikuar dhe procedura konkrete për mbikëqyrjen e fëmijëve gjatë gjithë kohës. | | | | | |
| | Matja:*Inspektimi i dokumentacionit dhe vëzhgime* | | | | | |
| | Tregues:<br>• *Qendra nuk akomodon të mitur të pashoqëruar.*<br>• *Marrëveshjet me shkrim me prindërit ose kujdestarët* | | | | | |

| STANDARDI 4: SIGURIA&MBROJTJA | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Ref** | **Kritere** | **Plot.** | **Plot. Pjes.** | **Nuk është plot.** | **N/A** | **Komente / Rekomandime** |
| | *ligjorë qëparashikojnë qartë se fëmijët duhet të jenë tërë kohën të mbikëqyrur.*<br>• *Incidentet që ndodhin me fëmijët kur këta të fundit nuk ishin të mbikëqyrur do të shënohen te dosja dhe do të diskutohen me prindërit.* | | | | | |
| 4.6 | **Qendra disponon të gjitha mjetet e domosdoshme dhe staf të kualifikuar në rastet e emergjencave** | | | | | |
| | Matja:*Diskutimi me stafin* | | | | | |
| | Tregues:<br>• *Siguria e qendrës dhe e përfituesve në24 orë.*<br>• *Anëtarët e stafit janë gjithmonë të disponueshëm – nëse jo, kur janë në detyrë, atëherë mund të kontaktohen me telefon.*<br>• *Mjetet e sigurisë në rastet e zjarrit, fatkeqësisë natyrore etj.*<br>• *Rregullat dhe procedurat e afishuara në vende të dukshme për përdorimin e mjeteve kundër zjarrit.*<br>• *Staf i kualifikuar për të menaxhuar situatat e emergjencës. (procedura, trajnime, prova të realizuara etj.).* | | | | | |
| 4.7 | **Qendra në rastet e identifikimit të cenimit të të drjtave të fëmijëve bashkëpunon dhe me Njësinë për Mbrojtjen e Fëmijëve (NJMF) të njësisë ku është i regjistruar fëmija.** | | | | | |
| | Matja: *Inspektimi i dosjeve, diskutimi me stafin* | | | | | |
| | Tregues:<br>• Kopje të referimeve që i janë bërë NJMF-së janë në dosje | | | | | |

**Standardi 5:** ***Banorët fuqizohen të marrin pjesë në vendimmarrjet që lidhen me jetën e tyre***

| **STANDARDI 5: PUNËSIMI&VETËADMINISTRIMI** | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Ref** | **Kritere** | **Plot.** | **Plot. Pjes.** | **Nuk është plot.** | **N/A** | **Komente / Rekomandime** |
| 5.1 | **Përfituesit, përfshirë edhe fëmijët, marrin informacionin e mjaftueshëm për të marrë pjesë në mënyrë aktive dhe të sigurt te procesi i vendimmarrjes.** | | | | | |
| | Matja: *Inspektimi i 10 dosjeve të përzgjedhura rastësisht dhe diskutimi me banorët* | | | | | |
| | Tregues:<br>• *Fëmijëve u jepet mundësia të diskutojnë situatën e tyre me punonjësit e rastit apo punonjës të tjerë përkatës në mënyrë të vazhdueshme dhe private.*<br>• *Informacion, si raporte dhe të dhëna të tjera, i jepen fëmijës në mënyrë të përshtatshme apo në gjuhë të përshtatshme për moshën dhe zhvillimin e fëmijës.*<br>• *Fëmijët mbështeten për të marrë pjesë në takimet ku planifikohen hapat e kujdesit për ta etj.*<br>• *Takimet dhe mbledhjet kryhen në një orar të përshtatshëm për fëmijën, p.sh. të mos përkojnë me orarin e shkollës etj.*<br>• *Dokumentacione të ndryshme të cilat vërtetojnë që fëmijët kanë qenë aktivëgjatë proceseve të vendimmarrjeve për ofrimin e shërbimeve.* | | | | | |
| 5.2 | **Përfituesit informohen për shërbimet që ofrohen në qendër dhe shërbime të tjera publike jashtë qendrës,** | | | | | |

| STANDARDI 5: PUNËSIMI&VETËADMINISTRIMI | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Ref** | **Kritere** | **Plot.** | **Plot. Pjes.** | **Nuk është plot.** | **N/A** | **Komente / Rekomandime** |
| | **përfshirë shërbimet për mbrojtjen e fëmijëve dhe ku mund të shkojnë për të kërkuar mbështetje** | | | | | |
| | Matja: *Diskutimi me banorët e stafin dhe vëzhgimi* | | | | | |
| | • *Janë të publikuara në vende të dukshme detajet sesi mund të kontaktohen agjencitë e tjera, për shembull ka një kënd botimesh ose ky informacion merret nga bisedat me punonjësin kyç /stafin dhe banorët e tjerë.* | | | | | |
| 5.3 | **Përfituesve u kërkohet në mënyrë aktive mendimi i tyre dhe merret në konsideratë gjatë marrjes së vendimeve për funksionimin e qendrës dhe programit vjetor.** | | | | | |
| | Matja: *Diskutime me banorët e stafin dhe inspektimin e dokumenteve.* | | | | | |
| | Tregues:<br>• *Protokolli i takimit me stafin/banorët tregon përfshirjen e tyre në vendimmarrje dhe dëshirat e ndjenjat e tyre.*<br>• *Dokumentacione ku tregohet pjesëmarrja aktive e përfituesve në vendimmarrje.* | | | | | |
| 5.4 | **Nënshkrimi i marrëveshjeve me shkrim dhe programeve të pranuara e të miratuara nga përfituesit/fëmijët.** | | | | | |
| | Matja: *Inspektimi i 10 dosjeve të përzgjedhura rastësisht dhe diskutime me banorët* | | | | | |
| | Tregues:<br>• *Marrëveshjet me shkrim për të përcaktuar qëllimin, rolin dhe pritshmëritë nga përfshirja te Qendra e Emergjencës.*<br>• *Programe puneku parashikohet mbështetja që do të jepet dhe pritshmëritë e përfituesve.* | | | | | |
| 5.5 | **Qendra disponon procedura të cilat mundësojnë të drejtën e ankimimit të tyre, përfshirë edhe fëmijët.** | | | | | |

| STANDARDI 5: PUNËSIMI&VETËADMINISTRIMI | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Ref** | **Kritere** | **Plot.** | **Plot. Pjes.** | **Nuk është plot.** | **N/A** | **Komente / Rekomandime** |
| | Matja: *Inspektimi i dokumentave dhe intervista me banorët* | | | | | |
| | Tregues:<br>• *Procedurat e ankimit të miratura nga drejtuesi dhe përfituesit e të publikuara.*<br>• *Procedurat e ankimit parashikojnëraportim dhe hetim të pavarur (për shembull me menaxherin dhe një agjenci tjetër).*<br>• *Të dhënat për ankimin (nëse ka) tregojnë hapat që janë ndërmarrë për hetim, rezultatet dhe zgjidhja qëështë dhënë.*<br>• *Afishimi i numrave të telefonit të institucioneve të pavaruara që mbrojnë të drejtat e njeriut (Avokati i Popullit, Shërbimi Social Shtetëror, Inspektorati i Shërbimeve Shoqërore etj.).* | | | | | |

**VENDIM**
**Nr. 573, datë 24.6.2015**

**PËR MIRATIMIN E STANDARDEVE TË SHËRBIMEVE TË NJËSIVE TË MBROJTJES SË FËMIJËVE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 4, të nenit 18, të ligjit nr. 9355, datë 10.3.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e standardeve të shërbimeve të njësive të mbrojtjes së fëmijëve, sipas dokumentit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, Ministria e Punëve të Brendshme, Ministria e Arsimit dhe Sportit, Ministria e Shëndetësisë dhe njësitë e qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Edi Rama**

STANDARDET E SHËRBIMEVE PËR NJËSITË E MBROJTJES SË FËMIJËVE

Hyrje

Hartimi i standardeve të shërbimeve për njësitë e mbrojtjes së fëmijëve, shënon një hap të rëndësishëm në garantimin dhe zhvillimin e mëtejshëm të të drejtave të fëmijëve shqiptarë, të sanksionuara në Kushtetutë, në legjislacionin shqiptar dhe në konventat ndërkombëtare të ratifikuara nga Qeveria Shqiptare si Konventa e Kombeve të Bashkuara për të Drejtat e Fëmijëve dhe ligjin nr. 10347, datë 4.11.2010, "Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës".

Vendosja e standardeve për shërbimet e njësive të mbrojtjes së fëmijëve është e rëndësishme për disa arsye:

Së pari, për të garantuar cilësinë e shërbimeve për mbrojtjen e fëmijëve në respektim të të drejtave të fëmijëve të sanksionuara në legjislacionin në fuqi.

Standardet e shërbimeve të njësive të mbrojtjes së fëmijëve mbështeten dhe synojnë respektimin e parimeve, si: respektimi dhe garantimi i vlerave dhe i personalitetit të individit; universaliteti; barazia e mundësive; e drejta për të përfituar; partneriteti; transparenca dhe paanshmëria; mosdiskriminimi; pavarësia, integrimi shoqëror dhe pjesëmarrja në jetën e komunitetit.

Shqipëria ka punuar me ritme të shpejta për të përmirësuar situatën e fëmijëve, të rrisë mbrojtjen e tyre dhe të promovojë të drejtat e fëmijëve në Shqipëri.

Krahas ndryshimeve ligjore në Kushtetutën e Shtetit Shqiptar, Kodin e Familjes, Kodin e Punës, Kodin Civil dhe atë të Procedurës Civile, Kodin Penal dhe atë të Procedurës Penale, edhe legjislacionin për mbrojtjen shoqërore ka pësuar përmirësime të dukshme me miratimin e ligjit nr. 10347, datë 4.11.2010, "Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve" dhe një sërë aktesh të tjera në zbatim të tij, si ngritja e modelit të ri të shërbimeve të njësive për mbrojtjen e fëmijëve (NJMF) si themeli i sistemit për mbrojtjen e fëmijëve; Protokollit të Punës për Mbrojtjen e Fëmijëve, si edhe miratimit të ndryshimeve ligjore në ligjin nr. 9355, datë 10.3.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", i ndryshuar, të cilat garantojnë dhe zhvillojnë më tej edhe të drejtat e fëmijëve.

Hartimi dhe implementimi i paketës së standardeve të shërbimeve të njësive të mbrojtjes së fëmijëve, në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe me standardet e kërkuara ndërkombëtare, përbën edhe një hap të rëndësishëm në procesin e integrimit të vendit tonë në Bashkimin Evropian.

Së dyti, vendosja e standardeve për shërbimin e njësive të mbrojtjes së fëmijëve do të shërbejë si detyrim ligjor ndaj strukturave në nivel qendror dhe vendor për të matur dhe për të përmirësuar cilësinë e shërbimeve për mbrojtjen e fëmijëve brenda territorit të tyre. Në kushtet e zhvillimit, del e nevojshme që shteti të vendosë disa rregulla dhe standarde për cilësinë e shërbimeve, që duhen respektuar nga të gjitha institucionet në nivel qendror dhe vendor.

Së treti, proceset decentralizuese ngarkojnë me përgjegjësi më të mëdha autoritetet vendore në lidhje me shërbimet për mbrojtjen e fëmijëve. Në kushtet që bashkitë nuk kanë përvojë në këtë fushë të re të veprimtarisë së tyre, vendosja e

standardeve do t'i ndihmojë ata në përmbushjen e funksioneve të reja në lidhje me plotësimin e nevojave sociale të komunitetit, ku ata ushtrojnë autoritetin e tyre. Këto funksione lidhen me planifikimin, sigurimin e shërbimeve të njësive të mbrojtjes së fëmijëve dhe zhvillimin e rrjeteve të bashkëpunimit rajonal apo lokal.

Së katërti, zbatimi i standardeve ndikon në rritjen e kapitalit social. Kapitali social në këndvështrimin praktik ka të bëjë me zhvillimin e rrjeteve të bashkëpunimit dhe të burimeve shoqërore, që përfshijnë institucionet, marrëdhëniet dhe normat që formojnë sasinë dhe cilësinë e ndërveprimeve shoqërore në një shoqëri.

Standardet, gjithashtu, do të shërbejnë si dokument bazë:

i) për Ministrinë e Mirëqenies Sociale dhe Rinisë, për të vlerësuar kapacitetet e autoriteteve vendore për funksionimin e njësive të mbrojtjes së fëmijëve;

ii) për strukturat e Inspektoratit të Punës dhe të Shërbimit Social, të cilat do të kontrollojnë cilësinë e shërbimeve;

iii) për autoritetet vendore për të vlerësuar shërbimin e njësive të mbrojtjes së fëmijëve për të planifikuar fonde në funksion të përmirësimit të shërbimit të njësive për mbrojtjen e fëmijëve;

iv) për organizatat që përfaqësojnë dhe mbrojnë të drejtat e fëmijëve, organizatave për të drejtat e njeriut, për të vlerësuar situatën e fëmijëve dhe realizimin e të drejtave të tyre;

v) për autoritetet në nivel qendror, si: Ministria e Shëndetësisë, e Arsimit dhe Sportit, e Brendshme, e Drejtësisë etj.;

vi) për institucionet akademike dhe organizatat e përfshira në veprimtari arsimore e trajnuese apo studiuesit e fushës etj.;

vii) për vetëvlerësimin e punës nga NJMF-të, si: dhe për raportimin tek Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve.

Krahas kësaj, standardet mund të përdoren për të krijuar njësi matëse për praktikën dhe për të identifikuar fushat ku ka nevojë për përmirësim, si për advokacinë ashtu edhe për nxitjen e përmirësimit të shërbimeve.

Kjo bën që standardet të mos shikohen më si thjesht "pajtim" me politikat, por të jenë të dobishme për të zhvilluar edhe më tej praktikën.

Për të ndihmuar zbatimin e standardeve dhe inspektimet, është e nevojshme të sigurohen dhe të zhvillohen udhëzime të mëtejshme teknike.

Shtrirja dhe baza e këtyre standardeve

Standardet bazohen te ligji nr. 9355, datë 10.3.2005, "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", të ndryshuar, dhe të ligjit nr. 10347, datë 4.11.2010, "Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve", dhe te dokumente të tjera me vlerë që përdoren për të rregulluar sistemin e mbrojtjes së fëmijëve në Shqipëri. Duke pasur parasysh fazën deri ku është zhvilluar sistemi për mbrojtjen e fëmijëve në Shqipëri, standardet qëllimisht janë hartuar sa më të thjeshta dhe të qarta, të pangarkuar me hollësi, por janë fokusuar te pikat më kryesore.

Kjo është përpjekja e parë për të zhvilluar standarde për të inspektuar NJMF-të dhe për këtë është e rëndësishme të jemi realistë për sa është e mundshme të realizohet. Është një zgjedhje pragmatike, pasi futja e standardeve të përpunuara mund të mos funksionojë në këto momente dhe të krijojë shkurajim. Prezantimi i standardeve kryesore në këtë kohë nënkupton që të gjitha përpjekjet duhet të përqendrohen për të garantuar plotësimin e standardeve minimale. Me zhvillimin e praktikës me kohën (si për mbrojtjen e fëmijëve dhe për inspektimet) do të zhvillohen edhe standardet.

**Formati i standardeve**

Standardet janë mbështetur në pesë fusha specifike, por të ndërlidhura midis tyre që përfshijnë kriteret për cilësinë. Krahas identifikimit të kritereve për çdo standard, janë përfshirë edhe shembuj treguesish për të ndihmuar vlerësimin nëse standardi është përmbushur ose jo. Gjithashtu, është identifikuar formati dhe metoda për mbledhjen e informacionit që ndihmon për vlerësimin (p.sh., "matja").

Standardet përfaqësojnë një nivel të përbashkët të funksionimit dhe të kryerjes së veprimtarisë që kërkohet të arrihet nga të gjitha llojet e shërbimeve sociale. Standardet janë parime të përgjithshme që shërbejnë për të siguruar cilësinë e shërbimeve, ato i drejtojnë shërbimet në plotësimin e nevojave të ndryshme të fëmijëve të komunitetit të cilit u shërbejnë. Standardet përbëjnë një nga tri elementet që sigurojnë një sistem bashkëkohor të shërbimeve sociale, element tjetër i rëndësishëm është edhe inspektimi i tyre.

Standardi 1: Sigurimi i burimeve të mjaftueshme dhe i një mjedisi të përshtatshëm pune për të mundësuar që puna për mbrojtjen e fëmijëve të bëhet në mënyrë efektive, të përshtatshme dhe të sigurt.

Rezultati përfundimtar i dëshiruar:

Njësitë e qeverisjes vendore sigurojnë burime të mjaftueshme njerëzore dhe mjedis të përshtatshëm për njësitë e mbrojtjes së fëmijëve (NJMF) në përputhje me kapacitetin, sigurinë, karakterin e shërbimit dhe nevojat e fëmijëve brenda komunitetit ku jetojnë. Fëmijët përfitojnë shërbime të mbrojtjes në kushte dhe në një mjedis të përshtatshëm, si dhe me burimet e nevojshme njerëzore brenda komunitetit ku jetojnë.

Standardi:

1.1 Shërbimet e ofruara nga njësitë e mbrojtjes së fëmijëve janë të disponushme në njësitë e qeverisjes vendore.

1.2 Njësitë e qeverisjes vendore sigurojnë ngritjen dhe funksionimin e njësisë së mbrojtjes së fëmijëve me staf të mjaftueshëm, të kualifikuar dhe me eksperiencë për të ofruar shërbimet për mbrojtjen e fëmijës.

1.3 Njësitë e qeverisjes vendore nëpërmjet njësive të mbrojtjes së fëmijëve të ngritura, ofrojnë mbrojtjen e fëmijëve dhe promovimin e të drejtave të tyre.

1.4 Shërbimet e ofruara nga njësitë e mbrojtjes së fëmijëve janë të aksesushme nga të gjithë fëmijët në territorin e NJQV-së ose komunitetit.

1.5 Shërbimi i njësisë së mbrojtjes së fëmijëve ushtron detyrat e tij funksionale në oraret e punës që përcaktohen në përputhje me legjislacionin në fuqi dhe në kontratën individuale të punës.

1.6 Njësitë për mbrojtjen e fëmijëve kanë mjedis të përshtatshëm pune që u mundëson garantimin e konfidencialitetit të të dhënave personale të fëmijës.

1.7 Njësitë e qeverisjes vendore sigurojnë burime materiale të mjaftueshme për ofrimin e shërbimit të njësive të mbrojtjes së fëmijëve.

1.8 Njësitë e qeverisjes vendore supervizojnë / mbikëqyrin periodikisht performancën në punë të njësive të mbrojtjes së fëmijëve sipas legjislacionit në fuqi.

Standardi 2: Zbatimi i procedurave të referimit dhe të menaxhimit të rasteve të fëmijëve në rrezik, për të siguruar mbrojtjen e fëmijës në mënyrë sistematike dhe të vazhdueshme.

Rezultati përfundimtar i dëshiruar:

Nëpërmjet zbatimit të procedurave të rregullta të identifikimit, vlerësimit, planifikimit, referimit dhe dhënies së shërbimeve nga njësitë e mbrojtjes së fëmijëve sigurohen shërbime eficiente, sistematike dhe në mënyrë të vazhdueshme sipas protokollit të punës për njësitë e mbrojtjes së fëmijëve.

2.1 Vlerësimi i rasteve të identifikuara/referuara dhe marrja e vendimit fillestar brenda 24 orëve.

2.2 Vlerësimi i plotë dhe gjithëpërfshirës i nevojave të fëmijës në rrezik.

2.3 Identifikimi i riskut dhe ndjekja e hapave për planifikimin e ndërhyrjes.

2.4 Hartimi i planit individual për mbrojtjen e fëmijës nga Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës dhe grupi teknik multidisiplinar.

2.5 Ndjekja e zbatimit të planit individual për mbrojtjen e fëmijës në mënyrë periodike dhe atëherë kur është e nevojshme.

2.6 Rishikimi i planit individual për mbrojtjen e fëmijës në mënyrë periodike dhe atëherë kur është e nevojshme.

2.7 Mbyllja e rastit.

2.8 Mbajtja dhe ruajtja e të dhënave të përditësuara në mënyrë të sigurt sipas udhëzimeve përkatëse në fuqi.

2.9 Raportimi periodik kryhet në zbatim të legjislacionit në fuqi.

2.10 Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës krijon klimë të sigurt për fëmijët dhe inkurajon mbrojtjen e tyre.

Standardi 3: Përfshirja e fëmijës dhe familjes në mënyrë aktive dhe të plotë.

Rezultati përfundimtar i dëshiruar:

Përfshirja e fëmijës dhe familjes gjatë gjithë procesit të ofrimit të shërbimit nga Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës.

3.1 Fëmijëve u jepet informacion dhe mbështetje e mjaftueshme për të marrë pjesë në mënyrë aktive dhe të sigurt te procesi i vendimmarrjes.

3.2 Fëmijët, familjet dhe komunitetet janë në dijeni të shërbimeve për mbrojtjen e fëmijëve dhe

të mënyrave se si mund të kërkojnë mbështetje ose mbrojtje.

3.3 Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës merr mendimin e fëmijës në mënyrë aktive dhe ky mendim mbahet parasysh kur merret vendim për mbrojtjen e fëmijëve.

3.4 Fëmijët shoqërohen përgjatë gjithë procesit të mbrojtjes për të ulur stresin dhe ankthin.

3.5 Prindërit përfshihen plotësisht në vendimet që lidhen me fëmijët e tyre.

3.6 Miratimi i ndërhyrjes për mbrojtje, dokumentohet në marrëveshje me shkrim me fëmijën dhe prindërit, atëherë kur kjo është e mundur.

Standardi 4. Përdorimi i një qasjeje multidisiplinare, gjatë procesit të menaxhimit të rastit, kur i ofrohen shërbime fëmijës dhe familjes.

Rezultati përfundimtar i dëshiruar: Rritja e cilësisë së shërbimeve nëpërmjet bashkërendimit efektiv të punës ndërmjet grupit teknik multidisiplinar dhe Njësisë për Mbrojtjen e Fëmijës.

4.1 Institucione dhe aktorë të tjerë të shoqërisë civile përfshihen për mbështetjen e fëmijëve dhe familjeve, duke përfshirë punën parandaluese dhe menaxhimin e rastit.

4.2 NJMF-ja bën përpjekje për forcimin e bashkëpunimit ndërmjet aktorëve vendorë për mbrojtjen e fëmijëve.

Standardi 5. Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës ofron shërbim cilësor në përputhje me nevojat e fëmijës.

Rezultati përfundimtar i dëshiruar: Fëmijët përfitojnë shërbime cilësore në përputhje me nevojat e tyre.

5.1 Vlerësimi dhe plani individual për mbrojtjen e fëmijës janë gjithëpërfshirës dhe i kushtojnë kujdes të veçantë interesit më të lartë të fëmijës.

5.2 Fuqizimi dhe mbështetja e familjes konsiderohen me prioritet.

5.3 Vendimi për të hequr një fëmijë nga familja mbështetet në interesin më të lartë të fëmijës.

5.4 Arsyet për vendosjen në kujdes alternativ janë të qarta dhe rishikohen rregullisht.

5.5 Lehtësohet dhe ruhet kontakti midis fëmijës dhe prindërve dhe vazhdimësia e aktiviteteve të mëparshme pasi fëmija vendoset në kujdes alternative.

5.6 Në rastet e lëvizjes së fëmijës – për shembull, në institucion rezidencial apo kthimi në familje - fëmija përgatitet për të kaluar situatën me sa më pak traumë dhe ankth.

5.7 Kërkohet mbështetje nga institucionet dhe shërbimet e tjera të specializuara kur është e nevojshme.

5.8 Gjatë procesit, punonjësi për mbrojtjen e fëmijës merr të gjitha masat dhe i kushton rëndësinë maksimale respektimit dhe ruajtjes së dinjitetit dhe konfidencialitetit të fëmijës dhe personave të përfshirë.

5.9 Ekzistojnë procedura për mbledhjen dhe shqyrtimin e ankesave të fëmijëve dhe familjeve lidhur me shërbimin e ofruar nga NJMF-ja.

.

**Standardet & Kriteret**
**Stadardi 1. Sigurimi i burimeve të mjaftueshme dhe i një mjedisi të përshtatshëm pune për të mundësuar që puna për mbrojtjen e fëmijëve të bëhet në mënyrë efektive, të përshtatshme dhe të sigurt.**

| STANDARDI 1: BURIMET & MJEDISI PUNËS | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Ref** | **Kriteret** | **Plot.** | **Pjes. Plot.** | **Nuk Plot.** | **N/A** | **Komente / Rekomandime** |
| 1.1 | **Shërbimet e ofruara nga Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve janë të disponushme në Njësitë e Qeverisjes Vendore.** | | | | | |
| | Matja: *Diskutim me bashkitë, Shërbimin Social Shtetëror dhe/ose Agjencinë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve.* | | | | | |
| | Tregues<br>• *Është e ngritur Njësia për mbrojtjen e fëmijës.*<br>• *Përshkrimet e punës për NJMF janë miratuar nga bashkia.* | | | | | |
| 1.2 | **Njësitë e Qeverisjes Vendore sigurojnë ngritjen dhe funksionimin e Njësisë së Mbrojtjes së Fëmijëve me staf të mjaftueshëm, të kualifikuar dhe me eksperiencë për të ofruar shërbimet për mbrojtjen e fëmijës** | | | | | |
| | Matja: Diskutimi me Punonjësin e MB | | | | | |
| | Tregues:<br>• Ekzistojnë dosjet që tregojnë punën e NJMF për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në rrezik. | | | | | |

| STANDARDI 1: BURIMET & MJEDISI PUNËS | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Ref | Kriteret | Plot. | Pjes. Plot. | Nuk Plot. | N/A | Komente / Rekomandime |
| | • Punonjësit e mbrojtjes së fëmijës kanë një Plan Pune për identifikimin në mënyrë proaktive të fëmijëve në rrezik.<br>• NJMF ofron shërbim për menaxhimin e rastit për çdo fëmijë që është banor i përhershëm apo i përkohshëm brenda territorit të NJQV.<br>• Çdo shërbim i ofruar fëmijës dhe familjes, referim apo vendim refelektohet në dosjen e fëmijës.<br>• Fëmijët nuk lihen në situata të pasigurta. NJMF ofron shërbim për mbrojtjen e fëmijës për çdo fëmijë që gjendet brenda territorit të NJQV, që sipas përcaktimeve të VKM 265 datë 12.4.2012 ndodhet në "situatë emergjente".<br>• Në mungesë të dikujt tjetër të përgatitur, NJMF referon/denoncon rastin në polici. | | | | | |
| 1.3 | **Njësitë e Qeverisjes Vendore nëpërmjet Njësive të Mbrojtjes së Fëmijëve të ngritura, ofrojnë mbrojtjen e fëmijëve dhe promovimin e të drejtave të tyre.** | | | | | |
| | Matja: Diskutimi me punonjësit e mbrojtjes se femijes, eprorin, dosjet e PMF, dhe dokumentacioni i ASHMDF, | | | | | |

| STANDARDI 1: BURIMET & MJEDISI PUNËS | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Ref** | **Kriteret** | **Plot.** | **Pjes. Plot.** | **Nuk Plot.** | **N/A** | **Komente / Rekomandime** |
| | etj. | | | | | |
| | Tregues<br>• Ekzistojnë dosjet që tregojnë punën e NJMF për menaxhimin e rasteve të fëmijëve në rrezik<br>• Punonjësit e mbrojtjes së fëmijës kanë një Plan Pune për identifikimin në mënyrë proaktive të fëmijëve në rrezik.<br>• NJMF ofron shërbim për menaxhimin e rastit për çdo fëmijë që është banor i përhershëm apo i përkohshëm brenda territorit të NJQV.<br>• Çdo shërbim i ofruar fëmijës dhe familjes, referim apo vendim refelektohet në dosjen e fëmijës.<br>• Fëmijët nuk lihen në situata të pasigurta. NJMF ofron shërbim për mbrojtjen e fëmijës për çdo fëmijë që gjendet brenda territorit të NJQV, që sipas përcaktimeve të VKM 265 datë 12.4.2012 ndodhet në "situatë emergjente".<br>• Në mungesë të dikujt tjetër të përgatitur, NJMF referon/denoncon rastin në polici | | | | | |
| 1.4 | **Shërbimet e ofruara nga Njësitë e Mbrojtjes së Fëmijëve janë të aksesushme nga të gjithë fëmijët në territorin e NJQV ose komuniteti.** | | | | | |

| STANDARDI 1: BURIMET & MJEDISI PUNËS | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Ref** | **Kriteret** | **Plot.** | **Pjes. Plot.** | **Nuk Plot.** | **N/A** | **Komente / Rekomandime** |
| | | | | | | |
| | Matja: *Diskutim me punonjësin për MB në bashki dhe përdoruesit e shërbimit / përfituesit dhe gjetjet.* | | | | | |
| | Tregues:<br>• *NJMF është në një zyrë që gjendet lehtë / afër ka transport publik.*<br>• *NJMF / Punonjësi MB është në një zyrë ku mund të shkojnë lehtësisht nga personat me aftësi të kufizuar ose ata në karrige me rrota (p.sh. jo me shumë shkallë dhe mundësisht me ashensor)*<br>• *NJMF ka një numër telefoni të bërë publik.* | | | | | |
| 1.5 | **Shërbimi i Njësisë së Mbrojtjes së Fëmijëve ushtron detyrat e tij funksionale në oraret e punës që përcaktohen në përputhje me legjislacionin në fuqi, në kontratën individuale të punës.** | | | | | |
| | Matja: *Diskutim me Punonjësin e MB & inspektimi pamor* | | | | | |
| | Tregues:<br>• *NJMF është e hapur gjatë orarit zyrtar të punës dhe në orare të tjera të ditës apo fundjavë sipas rregullimeve të bëra nga Njësia e Qeverisjes Vendore.*<br>• *NJMF le shënim sesi mund të kontaktohet punonjësi kur nuk ka njeri në zyrë (kur* | | | | | |

| STANDARDI 1: BURIMET & MJEDISI PUNËS | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Ref** | **Kriteret** | **Plot.** | **Pjes. Plot.** | **Nuk Plot.** | **N/A** | **Komente / Rekomandime** |
| | *është në vizita).*<br>• *Zyra e NJMF ka tabela të qarta që tregojnë se ku ndodhet*<br>• *Punonjësi NJMF mban celular kur nuk është në zyrë.*<br>• *Janë marrë masa për të zëvendësuar Punonjësin e MF kur është me leje / sëmurë. Shënim–shiko Standardin 5 – Shërbimet cilësore.* | | | | | |
| 1.6 | ***Njësitë për Mbrojtjen e Fëmijëve kanë mjedis të përshtatshëm pune*** **që u mundëson garantimin e konfidencialitetit të të dhënave personale të fëmijëve.** | | | | | |
| | Njësia Matëse: *Inspektimi pamor* | | | | | |
| | Tregues:<br>• *Punonjësi i MB ka zyrën e tij, me karrige ku mund të ulen vizitorët ose punonjësi për mbrojtjen e fëmijës ndan zyrën me të tjerë, por kur ka nevojë për takime apo intervista me fëmijët apo familjen sigurohet një mjedis/ zyrë tjeter i përshtatshëm për këtë qëllim.*<br>• *Zyra/ mjedisi i intervistimit ka dyer që mund të mbyllen për të garantuar konfidencialitetin gjatë bisedave me fëmijën dhe familjen.* | | | | | |

| STANDARDI 1: BURIMET & MJEDISI PUNËS | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Ref** | **Kriteret** | **Plot.** | **Pjes. Plot.** | **Nuk Plot.** | **N/A** | **Komente / Rekomandime** |
| 1.7 | **Njësitë e Qeverisjes Vendore sigurojnë burime materiale për ofrimin e sherbimit të Njësive të Mbrojtjes së Fëmijëve.** | | | | | |
| | Njësia Matëse: *Inspektimi pamor & diskutim me Punonjësin e MB* | | | | | |
| | Tregues:<br>• *Punonjësi mbrojtjes së femijës ka numër telefoni të ofruar nga institucioni ose i rimbursohet telefoni privat.*<br>• *Punonjësi mbrojtjes së femijës ka transport të siguruar që të vizitojë familjet – dhe kjo nuk është e kufizuar.*<br>• *Punonjësi mbrojtjes së femijës ka kompjuter dhe mjete kancelarike (letër, bojë printeri, dosje etj) që mundësojnë funksionimin optimal të NJMF.*<br>• *Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës ka fonde të përcaktuara nga NJQV për të plotësuar nevojat bazë të menjëhershme të familjeve në situatë emergjence.* | | | | | |
| 1.8 | Njësitë e Qeverisjes Vendore supervizojnë/mbikqyrin periodikisht performancën në punë të Njësive të Mbrojtjes së Fëmijëve sipas legjislacionit në fuqi. | | | | | |
| | Njësia Matëse: *Diskutimi me Punonjësin e NJMF, eprorin dhe dokumentacioni* | | | | | |

| STANDARDI 1: BURIMET & MJEDISI PUNËS | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Ref | Kriteret | Plot. | Pjes. Plot. | Nuk Plot. | N/A | Komente / Rekomandime |
| | Tregues:<br>• *Drejtuesi i NJMF është përgjegjës për të siguruar se punonjësi mbrojtjes së fëmijës mbikëqyret/ supervizohet.*<br>• *Mbikëqyrësi/Supervizuesi ka kualifikimet teknike dhe përvojën për të mbështetur punonjësit e mbrojtjes së fëmijës. Ka diplomë në Punë Sociale apo Psikologji dhe të paktën 5 vjet përvojë pune me fëmijët dhe familjet për mbrojtjen e fëmijëve.*<br>• *Mbikqyrja përfshin mbikëqyrjen teknike të punës për menaxhimin e rasteve, diskutime sesi mund të menaxhohen në mënyrë efektive rastet, diskutime për zbatimin e praktikave pozitive, etj.*<br>• *Nëse nuk ka burime të përshtatshme brenda për brenda institucionit, organizohet puna në mënyrë të tillë që punonjësit e mbrojtjes së fëmijës të kenë mbikëqyrje nga mbikqyrës/ supervizorë jashtë institucionit.*<br>• *Vendimet/diskutimet gjatë proçesit të mbikëqyrjes/supervizimit reflektohen tek dosjet e rastit.*<br>• *Shënimet / të dhënat e mbikëqyrjes mbahen nga mbikëqyrësi dhe / ose Punonjësi MF* | | | | | |

**Standardi 2: Menaxhimi i procedurave të shërbimit të Njësisë së Mbrojtjes së fëmijëve për të siguruar mbrojtjen e fëmijës në vazhdimësi.**

| STANDARDI 2: SISTEMET & PROCEDURAT | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Ref** | **Kritere** | **Plot.** | **Plot. Pjes.** | **Nuk është Plot.** | **N/A** | **Komente / Rekomandime** |
| 2.1 | **Vlerësimi i rasteve të identifikuara /referuara dhe marrja e vendimit fillestar bëhet mundësisht brenda 24 orëve,ose maksimalisht brenda 48 orëve.** | | | | | |
| | Njësia Matëse: *Inspektimi i 10 dosjeve rastësore (të paktën 4 me rrezik të lartë) dhe inspektimi pamor i të dhënave të tjera.* | | | | | |
| | Tregues:<br>• *Janë regjistruar të gjitha rastet e identifikuara / referuara në një bazë të dhënash apo regjistër.*<br>• *Proçesi i vendosjes për hapjen e një dosjeje rasti / apo mosmarrja e asnjë mase, etj do të shënohet qartë tek regjistri.*<br>• *Merret vendimi mundësisht brenda 24 orëve,ose maksimalisht brenda 48 orëve nëse do të hapet çështja bazuar tek vlerësimi paraprak.* | | | | | |
| 2.2 | **Vlerësimi i plotë dhe gjithëpërfshirës i nevojave të fëmijës në rrezik** | | | | | |
| | Njësia Matëse: *Inspektimi i 10 dosjeve në formë rastësore (të paktën 4 raste në rrezik të lartë).* | | | | | |
| | Tregues:<br>• *Tek dosjet e çështjes përfshihen formularët e plotësuar të vlerësimit të plotë dhe gjithëpërfshirës.* | | | | | |

| STANDARDI 2: SISTEMET & PROCEDURAT | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Ref | Kritere | Plot. | Plot. Pjes. | Nuk është Plot. | N/A | Komente / Rekomandime |
| | *Vlerësimi tregon si është përdorur informacioni i marrë për të krijuar ide për nevojat e fëmijës në rrezik.*<br>• *Vlerësimi plotësohet optimalisht brenda 10 ditësh, por jo më vonë se 20 ditë nga identifikimi i çështjes dhe nga hapja e dosjes.* | | | | | |
| 2.3 | **Identifikimi i rrezikut dhe ndjekja e hapave për planifikimin e ndërhyrjes** | | | | | |
| | Njësia Matëse: *Inspektimi 10 dosjeve të përzgjedhura në formë rastësore.* | | | | | |
| | Tregues:<br>• *Niveli rrezikut dhe kriteret për vlerësimin e nivelit të rrezikut, janë paraqitur qartë në dosje*<br>• *Plani tregon me hollësi çfarë hapash janë hedhur për të menaxhuar rrezikun.* | | | | | |
| 2.4 | **Hartimi i Planit Individual për Mbrojtjen e Fëmijës nga Njësia e Mbrojtjes së Fëmijës dhe grupi teknik multidisiplinar.** | | | | | |
| | Njësia Matëse: *Inspektimi i 10 dosjeve rastësore (të paktën 4 raste në rrezik të lartë) dhe diskutim me anëtarët e grupeve multidisiplinare.* | | | | | |
| | Tregues:<br>• *Dosja përfshin formularët e vlerësimit të plotësuar sipas udhëzimeve në fuqi.*<br>• *Planit Individual për Mbrojtjen e Fëmijës plotësohet brenda 5 ditësh pasi ka përfunduar vlerësimi.* | | | | | |

| STANDARDI 2: SISTEMET & PROCEDURAT | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Ref** | **Kritere** | **Plot.** | **Plot. Pjes.** | **Nuk është Plot.** | **N/A** | **Komente / Rekomandime** |
| | • *Për rastet me rrezik të mesëm dhe të lartë Planit Individual për Mbrojtjen e Fëmijës është diskutuar dhe është miratuar nga grupi teknik multidisiplinar. Diskutimi dhe miratimi i planit pasqyrohet në dosje sipas udhëzimeve në fuqi.* | | | | | |
| 2.5 | **Ndjeka e zbatimit të Planit Individual për Mbrojtjen e Fëmijës në mënyrë prokative dhe sipas afateve kohore te përcaktuara.** | | | | | |
| | Njësia Matëse: *Inspektimi 10 dosjeve rastësore (të paktën 4 raste në rrezik të lartë).* | | | | | |
| | Tregues:<br>• *Tek dosja e rastit përfshihen shënime për telefonatat / takimet që tregojnë si është ndjekur zbatimi rastit apo telefonata me agjencitë e tjera.*<br>• *Tek dosja e rastit përfshihen vizitat në familje / telefonatat me familjen për të monitoruar ecurinë e planit të kujdesit.*<br>• *Dosjet e rastit të hapura tregojnë evidence (shënime, vizita në familje, etj) që tregojnë se janë marrë masa tre muajt e fundit.*<br>• *Në dosje paraqiten raporte/ shënime që tregojnë për ndryshimet e situatës .* | | | | | |
| 2.6 | **Rishikimi i Planit Individual për Mbrojtjen e Fëmijës në mënyrë periodike dhe atëherë kur është e nevojshme.** | | | | | |

| STANDARDI 2: SISTEMET & PROCEDURAT | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Ref** | **Kritere** | **Plot.** | **Plot. Pjes.** | **Nuk është Plot.** | **N/A** | **Komente / Rekomandime** |
| | Njësia Matëse: *Inspektimi i 10 dosjeve rastësore (të paktën 4 raste në rrezik të lartë).* | | | | | |
| | Tregues:<br>• *Dosja e rastit përfshin rishikimet e planeve të kujdesit që tregojnë se takimi i parë i rishikimit është mbajtur 6 javë pas takimit për planin e parë të kujdesit dhe rishikimet vijuese bëhen çdo tre muaj.*<br>• *Shënime të dokumentuara për takimet e rishikimit të rastit.*<br>• *Planet e kujdesit tregojnë ndryshimet që janë bërë mbështetur tek diskutimet për rastin gjatë takimeve të rishikimit.* | | | | | |
| 2.7 | **Mbyllja e rasteve** | | | | | |
| | Njësia Matëse: *Inspektimi 10 dosjeve të zgjedhura në formë rastësore dhe i 5 dosjeve të mbyllura.* | | | | | |
| | Tregues:<br>• *Dosjet për rastin përmbajnë formularët e mbylljes dhe arsyet e hollësishme pse u mbyll rasti dhe është firmosur nga eprori.*<br>• *Rastet për të cilat nuk është marrë asnjë masë (p.sh. vizita apo vlerësime etj) për 3 muaj dhe ku niveli rrezikut është i ulët nuk lihen të hapura / aktive.* | | | | | |
| 2.8 | **Mbajtja dhe ruajtja e të dhënave të përditësuara në mënyrë të sigurtë sipas udhëzimeve përkatëse në fuqi.** | | | | | |

| STANDARDI 2: SISTEMET & PROCEDURAT | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Ref** | **Kritere** | **Plot.** | **Plot. Pjes.** | **Nuk është Plot.** | **N/A** | **Komente / Rekomandime** |
| | Njësia Matëse: *Inspektimi i 10 rasteve / dosjeve rastësore.* | | | | | |
| | Tregues:<br>• *Ka dosje për çdo fëmijë.*<br>• *Formularët me informacionin bazë janë përfshirë në dosje.*<br>• *Nuk ka fletë / shënime të shpërndara në dosje – të gjitha janë të sigurta.*<br>• *Kopjet e dokumenteve kryesorë – vlerësimi, plani kujdesit, rishikimet, etj. Janë vendosur me rend sipas datave.*<br>• *Librat me kontaktet me familjet, përfshi vizitat në familje dhe takimet / telefonatat me agjencitë e tjera janë në dosje dhe të përditësuara.*<br>• *Të dhëna për takimet / kontaktet nuk duhet të jenë më të vjetra se një javë.*<br>• *Shënimet për rastin që hidhen tek blloku/ditari i Punonjësit për MF nuk do të mbahen më shumë se një javë pa u transferuar në dosje.*<br>• *Baza e të dhënave kompjuterike (nëse ka) dhe dosjet fizike duhet të përputhen me njëra tjetrën.*<br>• *Dollapi/rafti i dosjeve apo zyra private përdoret vetëm nga punonjësi mbrojtjes së fëmijës.*<br>• *Dollapi / rafti / zyra do jenë gjithmonë të kyçura përveç rasteve kur punonjësi mbrojtjes së fëmijë është në zyrë.*<br>• *Çelësin e dollapit / raftit të dosjeve e mban* | | | | | |

| STANDARDI 2: SISTEMET & PROCEDURAT | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Ref | Kritere | Plot. | Plot. Pjes. | Nuk është Plot. | N/A | Komente / Rekomandime |
| | *punonjësi mbrojtjes së fëmijë ose ruhet në vend të sigurt (tek punonjësi sigurisë).*<br>• *Asnjë shënim që është për rastin nuk duhet të rrijë më shumë se një javë tek blloku / ditari i punonjësit të mbrojtjes së fëmijë pa u transferuar tek dosja.*<br>• *Asnjë dokument që lidhet me rastin / dosjet nuk lihet mbi tavolinë nëse nuk është duke u përdorur.* | | | | | |
| 2.9 | **Raportimi periodik kryhet në zbatim të legjislacionit në fuqi.** | | | | | |
| | Njësia Matëse: *Inspektimi dokumenteve, diskutime me punonjësin e mbrojtjes së fëmijë dhe me eprorin / Inspektoratin dhe Agjencinë Shtetërore.* | | | | | |
| | Tregues:<br>*Shkresa që tregojnë raportimin periodik dhe sipas legjislacionit në ASHMDF dhe institucione të tjera.* | | | | | |
| 2.10 | **Punonjësi për mbrojtjen e fëmijës krijon klimë të sigurt për fëmijët dhe inkurajon mbrojten e tyre.** | | | | | |
| | Njësia Matëse: *Inspektimi i dokumenteve, diskutime me Punonjësin e MF dhe fëmijët.* | | | | | |
| | Tregues:<br>• Fëmijët mbikëqyren me kujdes kur marrin pjesë në takime / zyrat e NJMF.<br>• Kur bëhet punë me fëmijët, si konsultime, marrja e mendimeve, etj, i kushtohet | | | | | |

| STANDARDI 2: SISTEMET & PROCEDURAT | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Ref** | **Kritere** | **Plot.** | **Plot. Pjes.** | **Nuk është Plot.** | **N/A** | **Komente / Rekomandime** |
| | rëndësi materialeve dhe metodologjisë që përdoret për të reduktuar sa më shumë vështirësitë tek fëmijët.<br>• Punonjësi i *mbrojtjes së fëmijë* (dhe anëtarët e grupit multidisiplinar) nënshkruajnë Kodin e Sjelljes, deklaratën e etikës për të punuar me fëmijët.<br>• Punonjësi i *mbrojtjes së fëmijë* është verifikuar në polici dhe është vlerësuar si person i sigurt për të punuar me fëmijët. | | | | | |

**Standardi 3: Përfshirja e fëmijës dhe familjes në mënyrë aktive dhe të plotë.**

| STANDARDI 3: PËRFSHIRJA E FËMIJËVE & FAMILJES | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Ref** | **Kritere** | **Plot.** | **Plot. Pjes.** | **Nuk është Plot.** | **N/A** | **Komente/ rekomandime** |
| 3.1 | **Fëmijëve ju jepet informacion dhe mbështetje e mjaftueshme për të marrë pjesë në mënyrë aktive dhe të sigurt në procesin vendim marrjes.** | | | | | |
| | Njësia Matëse: *Inspektimi i 10 rasteve rastësore dhe diskutim me përdoruesit e shërbimit* | | | | | |
| | Tregues:<br>• *Fëmijëve ju jepet mundësia të diskutojnë situatën e tyre me Punonjësit e MF apo punonjës të tjerë përkatës në mënyrë të vazhdueshme dhe private.*<br>• *Informacion si raporte dhe të dhëna të tjera i* | | | | | |

| STANDARDI 3: PËRFSHIRJA E FËMIJËVE & FAMILJES | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Ref** | **Kritere** | **Plot.** | **Plot. Pjes.** | **Nuk është Plot.** | **N/A** | **Komente/ rekomandime** |
| | *jepen fëmijës në mënyrë të përshtatshme apo në gjuhë të përshtatshme për moshën dhe zhvillimin e fëmijës.*<br>• *Fëmijët mbështeten për të marrë pjesë në takimet ku planifikohen hapat e kujdesit për ta, etj.*<br>• *Takimet dhe mbledhjet kryen në një orar të përshtatshëm për fëmijën, p.sh. të mos përkojnë me orarin e shkollës, etj.* | | | | | |
| 3.2 | **Fëmijët, familjet dhe komunitetet janë në dijeni të shërbimeve për Mbrojtjen e Fëmijëve dhe të mënyrave se si mund të kërkojnë mbështetje/mbrojtje.** | | | | | |
| | Njësia Matëse: *Diskutim me Punonjësit e NJMF të bashkisë dhe përdoruesit e shërbimit / përfituesit.* | | | | | |
| | *Tregues:*<br>• *Roli i NJMF promovohet në bashki, p.sh referimet tek drejtoritë e tjera / sensibilizimi për funksionet e NJMF me anë të posterave, fushatave të ndërgjegjësimit, etj.*<br>• *Detajet si të kontaktohet punonjësi mbrojtjes së fëmijë janë të publikuara dhe në dispozicion të përdoruesve të shërbimit / përfituesve.* | | | | | |
| 3.3 | **NJMF merr mendimin e fëmijës në mënyrë aktive dhe ky mendim mbahet parasysh në vendimin për mbrojtjen e fëmijëve.** | | | | | |

| STANDARDI 3: PËRFSHIRJA E FËMIJËVE & FAMILJES | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Ref | Kritere | Plot. | Plot. Pjes. | Nuk është Plot. | N/A | Komente/ rekomandime |
| | Njësia Matëse: *Inspektimi i 10 rasteve të përzgjedhura rastësisht dhe diskutim me përdoruesit e shërbimit.* | | | | | |
| | Tregues:<br>• *Tek Formati i Vlerësimit në dosjen e fëmijës, paraqiten mendimet, dëshirat dhe ndjenjat e fëmijës së bashku me tregues sesi janë marrë në konsideratë këto.*<br>• *Rishikimi i Planit përfshin edhe përditësimin e opinioneve më të fundit të fëmijës.*<br>• *Fëmijëve ju jepet mundësia të diskutojnë dëshirat dhe ndjenjat e tyre me punonjësin e mbrojtjes së fëmijë në vend privat dhe të sigurt (për shembull gjatë vizitave në familje) ose me një punonjës tjetër (në qendrat ditore) siç është parashikuar tek Plani.* | | | | | |
| 3.4 | **Fëmijët shoqërohen përgjatë gjithë procesit të mbrojtjes për të ulur stresin dhe ankthin.** | | | | | |
| | Njësia Matëse: *Inspektimi i 10 rasteve të përzgjedhura rastësisht dhe diskutim me përdoruesit e shërbimit.* | | | | | |
| | Tregues:<br>• *Fëmija informohet rregullisht nga punonjësi i mbrojtjes së fëmijë për zhvillimin e rastit të tyre.*<br>• *Punonjësi i mbrojtjes së fëmijë mban kontakte të rregullta me fëmijën, duke i dhënë mundësi* | | | | | |

| STANDARDI 3: PËRFSHIRJA E FËMIJËVE & FAMILJES | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Ref** | **Kritere** | **Plot.** | **Plot. Pjes.** | **Nuk është Plot.** | **N/A** | **Komente/ rekomandime** |
| | *fëmijës të diskutojë shqetësimet dhe të bëj pyetje.*<br>• *Fëmija shoqërohet tek të gjitha shërbimet e specializuara (përfshi policinë, etj.) përgjatë gjithë hetimit, nga punonjësi i mbrojtjes së fëmijë ose punonjës tjetër parashikuar tek Plani Individual për Mbrojtjen e Fëmijës.* | | | | | |
| 3.5 | **Prindërit përfshihen plotësisht në vendimet që lidhen me fëmijët e tyre.** | | | | | |
| | Njësia Matëse: *Inspektimi i 10 rasteve të përzgjedhura rastësisht dhe diskutim me përdoruesit e shërbimit.* | | | | | |
| | Tregues:<br>• *Të dhënat në dosje tregojnë sesi janë përfshirë prindërit tek vlerësimi dhe hartimi i planit të mbrojtjes.*<br>• *Prindërit mbështeten për të marrë pjesë tek takimet për planifikimin e kujdesit – për shembull ju ofrohet transport (shiko Standardin 1)*<br>• *Prindërit mbështeten për të marrë pjesë gjatë proceseve të ndryshme për shembull të shoqëruar nga Punonjësit MF.*<br>• *Vizitat në familje kryhen rregullisht në mënyrë që të merren dhe mendimet e prindërve në një mjedis që është më familjar dhe më i qetë.*<br>• *Prindërit informohen rregullisht nga Punonjësi MF.* | | | | | |

| STANDARDI 3: PËRFSHIRJA E FËMIJËVE & FAMILJES | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Ref** | **Kritere** | **Plot.** | **Plot. Pjes.** | **Nuk është Plot.** | **N/A** | **Komente/ rekomandime** |
| | • *Prindërve u jepet informacioni në mënyrë të përshtatshme.*<br>• *Takimet dhe vizitat organizohen në orare të përshtatshme për familjen që sigurojnë prezencën e tyre.* | | | | | |
| 3.6 | **Miratimi i ndërhyrjes për mbrojtje, dokumentohet në marrëveshje me shkrim me fëmijën dhe prindërit, atëherë kur kjo është e mundur.** | | | | | |
| | Njësia Matëse: *Inspektimi i 10 rasteve të përzgjedhura rastësisht dhe diskutim me përdoruesit e shërbimit.* | | | | | |
| | Tregues:<br>• *Marrëveshje me shkrim për të vendosur rolin, qëllimin dhe pritshmërinë nga përfshirja tek shërbimet e mbrojtjes së fëmijë (veç planit të kujdesit për shërbimet e specializuara kur është e nevojshme).*<br>• *Merret miratimi si nga fëmijët dhe nga familja për ndarjen e informacionit mbi rastin me profesionistë të tjerë, përfshirjen në aktivitete dhe referimi tek shërbimet e tjera dhe të gjitha hidhen në dosje.* | | | | | |

**Standardi 4 . Përdorimi i qasjes multidisiplinare nëpërmjet menaxhimit të rastit për mbështjetjen e fëmijës dhe familjes.**

| STANDARDI 4: PËRFSHIRJA ME AKTORË TË TJERË | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Ref** | **Kritere** | **Plot.** | **Plot. pjes.** | **Nuk është plot.** | **N/A** | **Komente / Rekomandime** |
| 4.1 | **Institucione dhe aktorë të tjerë të shoqërisë civile përfshihen për mbështetjen e fëmijëve dhe familjeve, duke përfshirë punën parandaluese dhe menaxhimin e rastit.** | | | | | |
| | Njësia Matëse: *Inspektimi i 10 rasteve të përzgjedhura rastësisht / dosje dhe diskutimi me agjenci të tjera dhe punonjës MF.* | | | | | |
| | Tregues:<br>• *Dosjet tregojnë përfshirjen e profesionistëve të tjerë gjatë planifikimit të rastit dhe rishikimeve dhe tregon edhe përfshirjen e aktorëve gjatë fazës së zbatimit.*<br>• *Vlerësimi bëhet në bashkëpunim / bashkëveprim me profesionistë të tjerë.*<br>• *Referimet që i janë bërë agjencive të tjera dhe shërbimeve të specializuara.*<br>• *Planet e kujdesit rishikohen në bashkëpunim me aktorët e tjerë të përfshirë në menaxhimn e rastit.*<br>• *Proçers-verbali i takimeve gjatë mbledhjes së grupit multidisiplinar është mbajtur për çdo takim.* | | | | | |
| 4.2 | **NJMF bën përpjekje për forcimin e bashkëpunimit ndërmjet aktorëve vendorë për mbrojtjen e fëmijëve.** | | | | | |

| STANDARDI 4: PËRFSHIRJA ME AKTORË TË TJERË | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Ref** | **Kritere** | **Plot.** | **Plot. pjes.** | **Nuk është plot.** | **N/A** | **Komente / Rekomandime** |
| | Njësia Matëse: D*iskutim me agjencitë e tjera dhe Punonjësin e MF.* | | | | | |
| | Tregues:<br>• *NJMF / Punonjësi i MF ka regjistër të përditësuar / listën me kontaktet e agjencive për referim.*<br>• *Dosjet përmbajnë ftesat/kërkesa që i janë dërguar nga punonjësit e mbrojtjes së fëmijëve agjencive të tjera për të marrë pjesë në takimin e grupit teknik multidisiplinar, apo bashkëpunime të tjera në kuadër të mbrojtjes së fëmijëve.*<br>• *NJMF organizon takime periodike me me profesionistë dhe autoritete shtetërore përgjegjëse më qëllim forcimin e bashkëpunimit ndërmjet aktorëve dhe harmonizimin e ndërhyrjeve.* | | | | | |

**Standardi 5: Njësia për Mbrojtjen e Fëmijës ofron shërbim cilësor në përputhje me nevojat e fëmijës.**

| STANDARDI 5: CILËSIA & PËRSHTATSHMËRIA E SHËRBIMIT | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Ref** | **Kritere** | **Plot.** | **Plot. pjes.** | **Nuk është plot.** | **N/A** | **Komente / Rekomandime** |
| 5.1 | **Vlerësimi dhe plani i kujdesit janë gjithëpërfshirës dhe i kushtojnë kujdes të veçantë interesit më të lartë të fëmijës.** | | | | | |
| | Njësia Matëse: *Inspektimi i 10 dosjeve të zgjedhura rastësisht dhe intervista me Punonjës MF.* | | | | | |

| STANDARDI 5: CILËSIA & PËRSHTATSHMËRIA E SHËRBIMIT | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Ref** | **Kritere** | **Plot.** | **Plot. pjes.** | **Nuk është plot.** | **N/A** | **Komente / Rekomandime** |
| | Tregues:<br>• *Dosjet tregojnë se plani kujdesit për fëmijët mbulon të gjitha nevojat, p.sh. arsimin, shëndetin etj. dhe shërbime të tjera mbështetëse (si këshillimi, etj.)*<br>• *Qasja individuale për të gjitha rastet vërtetohet nëpërmjet krahasimit të planeve të vlerësimit dhe të kujdesit për çështjet e ndryshme dhe këto shfaqin dallimet – jo të gjitha planet / vlerësimet janë kopje të njëra tjetrës.*<br>• *Planet e kujdesit përfshijnë masat rezervë (nëse masat që ishin parashikuar tek plani nuk mund të kryhet / planet alternative).* | | | | | |
| 5.2 | **Fuqizimi dhe mbështetja e familjes konsiderohen me prioritet.** | | | | | |
| | Njësia Matëse: *Inspektimi i 10 dosjeve rastësore dhe intervistë me aktorët.* | | | | | |
| | Tregues:<br>• *Plani tregon me hollësi çfarë hapash janë hedhur për të mbështetur familjen që fëmija të qëndrojë në shtëpi, si ndihmë praktike edhe në forma të tjera (p.sh. këshilla, mbështetje emocionale).*<br>• *Familjet fuqizohen që të marrin përgjegjësi për fëmijët e tyre, nëpërmjet aftësive të prindërimit dhe të jetës.*<br>• *Në rastet kur fëmija ndahet, objektivi i planit të kujdesit duhet të jetë bashkimi familjar (kur mjedisi në familje është i sigurt për fëmijën) pra në thelb është bashkimi i familjes.* | | | | | |

| STANDARDI 5: CILËSIA & PËRSHTATSHMËRIA E SHËRBIMIT | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Ref** | **Kritere** | **Plot.** | **Plot. pjes.** | **Nuk është plot.** | **N/A** | **Komente / Rekomandime** |
| 5.3 | **Vendimi për të hequr një fëmijë nga familja mbështetet në interesin më të lartë të fëmijës.** | | | | | |
| | Njësia Matëse: *Inspektimi i 10 dosjeve rastësore për fëmijët që nuk janë në familje.* | | | | | |
| | Tregues:<br>• *Dosja përmban hollësi pse nuk mund të qëndrojë në shtëpi fëmija dhe çfarë hapash janë marrë / konsideruar që fëmija të qëndronte në shtëpi (për shembull planet e kujdesit ose tek shënimet e takimeve).*<br>• *Vendime të qarta dhe racionale në dosje që tregojnë pse u zgjodh kujdesi alternative dhe pse kjo zgjidhje plotëson nevojat e fëmijës ( fakti se largimi ka qenë e vetmja zgjidhje NUK është arsye e vlefshme).*<br>• *Dosja përmban dhe alternativat e tjera që janë kërkuar, p.sh kujdesi nga familja e gjerë / të afërm të tjerë).*<br>• *Dosja përmban arsyet pse janë ndarë vëllezërit/motrat gjatë vendosjes në kujdesin alternativ.* | | | | | |
| 5.4 | **Arsyet për vendosjen e fëmijës në kujdes alternativ janë të qarta dhe vendimi rishikohet rregullisht.** | | | | | |
| | Njësia Matëse: *Inspektimi i 10 dosjeve rastësore për fëmijët që nuk janë në familje.* | | | | | |
| | | | | | | |

| STANDARDI 5: CILËSIA & PËRSHTATSHMËRIA E SHËRBIMIT | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Ref** | **Kritere** | **Plot.** | **Plot. pjes.** | **Nuk është plot.** | **N/A** | **Komente / Rekomandime** |
| | Tregues:<br>• *Plani identifikon sa kohë do zgjasë ndarja nga familja dhe cilat janë hapat e radhës.*<br>• *Plani për bashkëpunimin me institucionet rezidenciale apo shërbimet alternative rishikohet rregullisht .* | | | | | |
| 5.5 | **Lehtësohet dhe ruhet kontakti midis fëmijës dhe prindërve dhe vazhdimësia e aktiviteteve të mëparshme pasi fëmija vendoset në kujdes alternativ.** | | | | | |
| | Njësia Matëse: *Inspektimi i 10 dosjeve rastësore kur fëmijët nuk janë në familje dhe intervista me aktorët (p.sh fëmijët).* | | | | | |
| | Tregues:<br>• *Plani përmban hollësi për masat që janë marrë për të ruajtur kontaktin midis prindërve dhe fëmijëve dhe midis vëllezër – motrave.*<br>• *Janë identifikuar mënyrat e përshtatshme për të ruajtur kontaktin me shkollën, shokët dhe bashkëmoshatarë.* | | | | | |
| 5.6 | **Në rastet e lëvizjes së fëmijës – për shembull, në institucion rezidencial apo kthimi në familje - fëmija përgatitet për të kaluar situatën me sa më pak traumë dhe ankth.** | | | | | |

| STANDARDI 5: CILËSIA & PËRSHTATSHMËRIA E SHËRBIMIT | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Ref** | **Kritere** | **Plot.** | **Plot. pjes.** | **Nuk është plot.** | **N/A** | **Komente / Rekomandime** |
| | Njësia Matëse: *Inspektimi i 10 dosjeve rastësore ku fëmijët nuk janë në shtëpi dhe intervista me prindërit dhe fëmijët.* | | | | | |
| | Tregues:<br>• *Lëvizja planifikohet paraprakisht.*<br>• *Dosja tregon mbështetjen që është dhënë/ konsultimin me fëmijët.*<br>• *Fëmijët kanë kohën e nevojshme për t'u përshëndetur me të afërm/ fëmijë të tjerë.*<br>• *Fëmijëve ju jepen numra telefoni që mbeten në kontakt.*<br>• *Nëse kthehen në shtëpi / familje, kjo bëhet në mënyrë graduale.*<br>• | | | | | |
| 5.7 | **Kërkohet mbështetje nga institucionet dhe shërbimet e tjera të specializuara kur është e nevojshme.** | | | | | |
| | Njësia Matëse: *Inspektimi 10 dosjeve rastësore dhe inspektimi me aktorët.* | | | | | |
| | Tregues:<br>• *Referimi i të dhënave të dosjes, bashkëpunimi me agjencitë e tjera për të plotësuar nevojat e fëmijëve dhe këto përfshihen tek Plani.*<br>• *Aktorët për mbrojtjen e fëmijëve, si policia dhe prokuroria konsultohen dhe përfshihen kur është e nevojshme.* | | | | | |

| STANDARDI 5: CILËSIA & PËRSHTATSHMËRIA E SHËRBIMIT | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| **Ref** | **Kritere** | **Plot.** | **Plot. pjes.** | **Nuk është plot.** | **N/A** | **Komente / Rekomandime** |
| | • *Referimet bëhen për të mbështetur dhe fëmijën dhe prindërit.* | | | | | |
| 5.8 | **Gjatë proçesit punonjësi për mbrojtjen e fëmijës merr të gjitha masat dhe i kushton rëndësinë maksimale respektimit dhe ruajtjes së dinjitetit dhe konfidencialitetit të fëmijës dhe personave të përfshirë.** | | | | | |
| | Njësia Matëse: *Inspektimi i 10 dosjeve rastësore, vëzhgime dhe diskutim me përdoruesit e shërbimit.* | | | | | |
| | Tregues:<br>• *Punonjësit e mbrojtjes së fëmijë tregojnë respekt gjatë ndërveprimit me fëmijët dhe familjet.*<br>• *Fëmijët dhe familjet përfshihen në vendim-marrje dhe ju jepet mundësia të zgjedhin.*<br>• *Punonjësi i mbrojtjes së fëmijë ruan kufijtë e duhur profesional.*<br>• *Referimet dhe kërkesat për mbështetje ndiqen në mënyrë proaktive dhe profesionale.*<br>• *Punonjësi i mbrojtjes së fëmijë siguron ruajtjen e konfidencialitetit dhe nuk identifikon fëmijët dhe familjet si përdorues shërbimi në diskutime publike ose në media.*<br>• *Punonjësi i mbrojtjes së fëmijë bën përpjekje që fëmijët dhe familjet të mos përsërisin/diskutojnë disa herë problemin e tyre në gjykatë ose me profesionistë të ndryshëm.* | | | | | |

| STANDARDI 5: CILËSIA & PËRSHTATSHMËRIA E SHËRBIMIT | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|
| Ref | Kritere | Plot. | Plot. pjes. | Nuk është plot. | N/A | Komente / Rekomandime |
| | | | | | | |
| 5.9 | **Ka procedura të qarta për mbledhjen dhe shqyrtimin e ankesave të fëmijëve dhe familjeve lidhur me shërbimin e ofruar nga NJMF.** | | | | | |
| | Njësia Matëse: *Inspektimi i dokumentacionit dhe intervista me përdoruesit e shërbimit.* | | | | | |
| | Tregues:<br>• *Ka politika për ankesat dhe ju tregohen fëmijëve dhe familjeve që përfshihen tek shërbimet e mbrojtjes së fëmijë.*<br>• *Politika për ankesat është në formë të pavarur raportimi dhe hetimi (për shembull menaxheri ose ndonjë agjenci tjetër).*<br>• *Të dhëna për ankesat (nëse ka) tregojnë dhe hapat që janë ndërmarrë për të hetuar, rezultatet dhe zgjidhjen.* | | | | | |

**VENDIM**
**Nr. 574, datë 24.6.2015**

**PËR KRITERET E TREGTIMIT, CERTIFIKIMIT DHE TESTIMIT TË FARËS SË PATATES[1]**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4, pika 9, 14, pika 3, 15, pika 3, 16, pika 4 dhe 33, pika 6, të ligjit nr. 10416, datë 7.4.2011, "Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

I. TË PËRGJITHSHME

1. Qëllimi i këtij vendimi është të përcaktojë kriteret për tregtimin e farës së patates, kategoritë, identitetin dhe cilësinë e tyre, rregullat e ambalazhimit dhe të etiketimit, procedurën e certifikimit, kriteret e ruajtjes, marrjes së mostrave për analiza laboratorike për certifikim, si dhe procedurën e testimit e provat krahasuese për kontrollin e farës së patates që vendoset në treg.

2. Të gjithë termat e përcaktuar në ligjin nr. 10416, datë 7.4.2011, "Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor", të ndryshuar, kanë të njëjtin kuptim edhe në këtë vendim.

II. KRITERET E TREGTIMIT TË FARAVE TË PATATES

1. Kriteret që duhet të plotësojnë farat e patates për tregtim, janë:

a) Të kenë të përcaktuar kategorinë, identitetin dhe cilësinë, sipas kërkesave të këtij vendimi;

b) Të jenë të pajisura me certifikatën zyrtare, sipas modelit të përcaktuar në shtojcën IV, bashkëlidhur këtij vendimi;

c) Të jenë të paketuara dhe të etiketuara, në përputhje me kriteret e pikës 3 të këtij kreu;

ç) Varieteti, prej të cilit është prodhuar fara, të jetë i regjistruar në katalogun kombëtar;

d) Të plotësojnë kërkesat e legjislacionit për mbrojtjen e shëndetit të bimëve dhe mbrojtjen e biodiversitetit, lidhur me masat mbrojtëse kundër futjes apo përhapjes së organizmave të dëmshëm, brenda territorit të Republikës së Shqipërisë.

2. Kategoritë, identiteti dhe cilësia e farave të patates

2.1 Sipas prejardhjes, farat e patates ndahen në kategoritë e mëposhtme:

a) Farë parabazë;

b) Farë bazë;

c) Farë e certifikuar.

2.2 Fara parabazë përfitohet nga shumëzimi i farave (tuberëve) në ngastrat e shumëzimit të farave të zgjedhura, nën përgjegjësinë e seleksionerit për mbrojtjen e varietetit.

2.3 Fara bazë nënkupton tuberët e patateve, të prodhuar nën përgjegjësinë e seleksionerit, sipas praktikave për mbrojtjen e varietetit, që ka për qëllim prodhimin e farës së kategorisë "Farë e certifikuar" dhe plotëson kërkesat e shtojcave I dhe II.

2.4 Fara e certifikuar nënkupton tuberët e patates, të prodhuar direkt nga fara bazë, që ka për qëllim prodhimin e patates dhe plotëson kërkesat e shtojcës I dhe II, bashkëlidhur këtij vendimi.

2.5 Skemat e prodhimit të kategorive të farës së patates bëhen nën monitorimin dhe përgjegjësinë e Entit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve (ESHFF).

2.6 Identiteti i farës së patates është tërësia e veçorive botanike, gjenetike, biologjike dhe morfologjike, si dhe qëllimi i përdorimit të një specieje të caktuar, për ta dalluar nga speciet e tjera. Sipas këtij kriteri, farë patateje do të konsiderohet fara (tuberi) që rrjedh nga bimët e patates (*Solanum tuberossum L.*).

2.7 Cilësia e farës së patates përcaktohet nga këta tregues:

a) Pastërtia e përgjithshme, që është pesha, në përqindje, e tuberëve të pastër, ndaj peshës së tyre të përgjithshme;

b) Aftësia mbirëse, që është aftësia e tuberëve për të mbirë në kushte të caktuara dhe që përcaktohet nga numri i kërcejve ose sythave (jo më pak se dy), që mbijnë, në raport me numrin e përgjithshëm (të tuberëve), të vënë për mbirje.

3. Ambalazhimi dhe etiketimi i farës së patates

3.1 Ambalazhimi i farës së patates të çdo kategorie shoqërohet me dy lloje etiketash, që janë etiketa e prodhuesit dhe etiketa zyrtare, që përgatitet e lëshohet në treg nga ESHFF-ja. Etiketa zyrtare vërteton që fara e patates është certifikuar dhe kontrolluar nga sektori i certifikimit në ESHFF.

3.2 Farat e patateve të kategorive "Farë parabazë", "Farë bazë" dhe "Farë e certifikuar" duhet të tregtohen

1 Ky vendim është përafruar pjesërisht me direktivën 2002/56/EC, të Këshillit, datë 13 qershor 2002, "Për tregtimin e farës së patates"; numri CELEX 32002L0056-EN. Fletorja Zyrtare e Bashkimit Evropian, seria L, nr. 193, datë 20.7.2002, faqe 60-73.

vetëm në lote homogjene dhe të paketuara.

3.3 Ambalazhet e kategorive "Farë parabazë", "Farë bazë" dhe "Farë e certifikuar" duhet të kryhen në mënyrë të tillë që, nëse hapen, mbyllja ose vetë paketimi të lënë gjurmë dëmtimi mbi etiketën zyrtare ose mbi vetë paketimin.

3.4 Riambalazhimi i farës së patates bëhet në rastin e rikontrollit laboratorik, për verifikimin e treguesve cilësorë të tuberëve, me kërkesë të furnizuesit. Nëse riambalazhohet, riambalazhimi dhe data e riambalazhimit duhet të shënohet në etiketë nga ESHFF-ja.

3.5 Ambalazhimi i kategorive "Farë bazë" dhe "Farë e certifikuar", të çdo lloji, duhet:

a) të jetë i pajisur, në pjesën e jashtme, me një etiketë zyrtare që plotëson kushtet e përcaktuara në shtojcën III, bashkëlidhur këtij vendimi, dhe të shkruar në gjuhën shqipe;

b) të përmbajë një dokument zyrtar, në të njëjtën ngjyrë me etiketën, që të pasqyrojë, të paktën, kërkesat e përcaktuara në pikat 3, 4 e 6, të shkronjës A, të shtojcës III. Ky dokument duhet të jetë i tillë që të mos zëvendësojë etiketën zyrtare, të përcaktuar në shkronjën "a", të kësaj pike.

3.6 Gjatë certifikimit zyrtar, autoriteti certifikues verifikon që paketimi i kategorive "Farë bazë" apo "Farë e certifikuar", të përmbajë edhe etiketën e furnizuesit, e cila duhet të jetë me ngjyrë të ndryshme nga etiketa zyrtare.

3.7 Farat e shumëzuara nga riprodhimet e kategorisë "Farë parabazë" mund të tregtohen si kategoritë "Farë bazë" dhe "Farë e certifikuar", kur plotësojnë kushtet e mëposhtme:

a) të jenë kontrolluar zyrtarisht, nga autoriteti certifikues, në përputhje me kërkesat që zbatohen për certifikimin e kategorive "Farë bazë" dhe "Farë e certifikuar";

b) të jenë të ambalazhuara në përputhje me kërkesat e këtij vendimi;

c) ambalazhet dhe paketat duhet të kenë një etiketë zyrtare, ku të shënohen, të paktën, të dhënat e mëposhtme:

i) autoriteti certifikues;

ii) numri i referencës së lotit;

iii) muaji dhe viti i marrjes së mostrave zyrtare të fundit, për qëllime certifikimi;

iv) specia, duke shënuar, të paktën, emrin botanik, e cila mund të jepet në formë të shkurtuar dhe pa emrin e autorit;

v) varieteti;

vi) riprodhimi;

vii) numri i serisë së etiketës;

viii) ngjyra e etiketës të jetë në përputhje me kategorinë përkatëse.

3.8 Çdo trajtim me plehra të përdorimit për bimësinë ose produkte të mbrojtjes së bimëve, që u është bërë kategorive "Farë bazë" dhe "Farë e certifikuar", shënohet në etiketën zyrtare ose në etiketën e furnizuesit, sipas modelit të përcaktuar në shtojcën III, në përputhje me legjislacionin përkatës në fuqi.

III. CERTIFIKIMI I FARËS SË PATATES

1. Dokumentacioni dhe procedura e certifikimit

1.1 Procedurat e certifikimit të farës së patates realizohen nga autoriteti certifikues ose nga subjekte publike apo private, sipas përcaktimit në kreun IX, të ligjit nr. 10416, datë 7.4.2011, të ndryshuar.

1.2 Kërkesat që duhet të plotësohen për certifikimin e farës së patates të prodhuar në vend dhe procedura e certifikimit të tyre janë, si më poshtë vijon:

a) për certifikimin e farave të patates, pranë autoritetit certifikues duhet të paraqiten dokumentet e mëposhtme:

i) kërkesa me shkrim për certifikimin e farës së patates;

ii) licenca përkatëse, e lëshuar nga Qendra Kombëtare e Licencimit;

iii) aktkontrolli për caktimin e ngastrës së farës, zbatimi i kërkesave agroteknike të teknologjisë së prodhimit të farave, sipas metodikave të hartuara për farën e patates dhe modelit të dhënë në shtojcën IV;

iv) certifikata e origjinës, që vërteton pastërtinë gjenetike të varietetit;

v) certifikata fitosanitare, lëshuar nga shërbimi fitosanitar;

vi) aktaprobimi fushor;

vii) etiketa e prodhuesit;

viii) deklarata e konformitetit.

b) Autoriteti certifikues ndjek procedurën e certifikimit, si më poshtë vijon:

i) Bën verifikimin e dokumentacionit dhe të kontingjentit të farës së patates që do të certifikohet, si dhe verifikon nëse varieteti është i regjistruar në Katalogun Kombëtar. Pasi konstaton plotësimin e kërkesave për dokumentacionin e mësipërm, plotëson procesverbalin për verifikimin e specifikimeve teknike, dokumentacionin, si dhe kontrollin e cilësisë së farës së patates;

ii) Përgatit dosjen e certifikimit për vlerësim mbi bazën e procesverbalit dhe dokumentacionit të mësipërm;

iii) Mbi bazën e vlerësimit të dosjes, lëshon certifikatën zyrtare, në të cilën shënohet sasia dhe numri i serisë së etiketave zyrtare që i jepen prodhuesit;

iv) Etiketa zyrtare vendoset në çdo njësi paketimi, sipas numrit të serisë, të përcaktuar në certifikatën zyrtare;

v) Elementet dhe kriteret e etiketës duhet të jenë sipas shkronjës "A", të shtojcës III, të këtij vendimi;

vi) Certifikata zyrtare lëshohet pasi të jetë likuiduar tarifa e certifikimit dhe të jenë tërhequr e plotësuar, nga prodhuesi, sasitë e etiketës zyrtare.

1.3 Procedura e vlerësimit të dosjes së certifikimit, si dhe lëshimi i certifikatës zyrtare përfundojnë brenda 10 (dhjetë) ditëve nga data e dorëzimit të kërkesës për certifikim.

1.4 Për rastet kur ESHFF-ja autorizon kryerjen e procedurave të certifikimit dhe subjekti i autorizuar nuk e përfundon këtë procedurë, brenda afatit të përcaktuar në pikën 1.3 të këtij kreu, atëherë të interesuarit mund të dorëzojnë ankesë pranë ESHFF-së.

1.5 Nëse ESHFF-ja nuk e përfundon procedurën e certifikimit brenda afatit të përcaktuar në pikën 1.3, atëherë të interesuarit mund të dorëzojnë ankesë pranë ministrit të Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave.

1.6 Forma dhe përmbajtja e dokumentacionit që i bashkëngjitet kërkesës për certifikim të farës së patates është sipas shtojcës IV, bashkëlidhur këtij vendimi.

2. Kriteret e ruajtjes, kontrolli fitosanitar dhe treguesit cilësorë për certifikim

2.1 Fara e patates duhet të mbahet në mjedise të përshtatshme, të cilat, gjatë përpunimit, paketimit, ruajtjes dhe tregtimit, sigurojnë temperaturën dhe lagështirën optimale për ruajtjen e treguesve cilësorë, sipas parametrave teknikë për farën e patates. Mjediset e përpunimit duhet të jenë të pajisura me impiante e pajisje për pastrimin, homogjenizimin, kalibrimin, dezinfektimin, peletimin dhe paketimin e farës së patates. Këto mjedise duhet të jenë të pajisura me aktmiratimin higjieno-sanitar, të lëshuar nga strukturat lokale të shëndetit publik, si dhe me certifikatë për dezinfektimin, dezinsektimin, deratizimin, të lëshuar nga subjekte të licencuara, sipas legjislacionit në fuqi.

2.2 Fara e patates tregtohet, si e tillë, vetëm pasi të jetë përpunuar, pastruar, homogjenizuar e kalibruar. Nëse gjatë përpunimit fara e patates mund të dezinfektohet e peletohet me pesticide dhe lëndë kimike ushqyese, atëherë duhet të shoqërohet me shënimin përkatës në etiketë.

2.3 Furnizuesve të farës së patates u lejohet që, në mjediset e tyre, të përpunojnë, paketojnë dhe etiketojnë farën e patates edhe për furnizues të tjerë, të licencuar për prodhimin, riprodhimin, shumëzimin e tregtimin e tyre.

2.4 Procesi i analizës fitosanitare të farës së patates për certifikim kryhet mbi mostrën, si një sasi fare e marrë në një ose disa pika të lotit të farës.

2.5 Mostrat për analizën e farës së patates, për qëllim certifikimi, duhet të merren zyrtarisht nga specialistët e autoritetit certifikues ose specialistë të tjerë, të autorizuar nga ESHFF-ja, në përputhje me metodat teknike, të përcaktuara me urdhër të ministrit.

2.6 Për ekzaminimin e farës së patates, për certifikim, mostrat duhet të nxirren nga lote homogjene. Pesha maksimale e një loti dhe pesha minimale e një mostre përcaktohen në shtojcën II, bashkëlidhur këtij vendimi.

IV. PROCEDURA DHE METODAT E TESTIMIT TË VARIETETEVE QË REGJISTROHEN NË KATALOGUN KOMBËTAR

1. Procedurat dhe metodat e kryerjes së testimit

1.1 Testimi i një varieteti ka për qëllim kryerjen e provave zyrtare mbi farën e patates, për të verifikuar plotësimin e kërkesave për vlerat e kultivimit dhe përdorimit të tyre, për dallueshmëri, uniformitet dhe stabilitet (DUS), me qëllim regjistrimin në Katalogun Kombëtar.

1.2 Testimi i varietetit bëhet në kuadër të kërkesës së të interesuarit për regjistrimin e këtij varieteti në Katalogun Kombëtar dhe kryhet nga ESHFF-ja, ose subjekte publike apo private të autorizuara, që veprojnë në fushën e bujqësisë, në përputhje me nenin 49, të ligjit nr. 10416, datë 7.4.2011, të ndryshuar, më poshtë "autoriteti testues".

1.3 Aplikanti, për regjistrimin e varieteteve të reja në Katalogun Kombëtar, duhet të paraqesë:

a) kërkesë me shkrim pranë ESHFF-së;

b) skedën e karakteristikave për kultivarin që do të testohet;

c) rezultatet e provave të seleksionerit;

ç) fotografi të bimës apo të frytit;

d) sasinë e farës për mbjellje, sipas normativave të miratuara me udhëzim të ministrit përgjegjës për bujqësinë.

1.4 Procedura e testimit të varietetit, e cila kryhet nga autoriteti testues, përfshin:

a) zbatimin nga ESHFF-ja të metodikave të hartuara nga UPOV-i;

b) kryerjen e provave, sipas metodikave të sipërcituara, dhe ndjekjen e fazave të zhvillimit të bimëve;

c) përpunimin e të dhënave dhe përgatitjen e raportit përfundimtar, për ta paraqitur në Komisionin e Vlerësimit të Varieteteve për Regjistrim në Katalogun Kombëtar.

1.5 Provat për testimin e varieteteve, për vlerën e kultivimit dhe përdorimit, kryhen sipas këtyre afateve:

a) për varietetet e krijuara në vend, për jo më pak se 2 (dy) vjet, plus prova për DUS-in;

b) për varietetet e prodhuara në shtetet anëtare të Bashkimit Evropian, ose në shtetet që kanë nënshkruar Konventën e UPOV-it, në rastet kur bëhet testimi, kryhet për 1 (një) vit;

c) për varietetet e prodhuara në vendet që nuk janë anëtare të Bashkimit Evropian ose nënshkruese të Konventës së UPOV-it, testimi kryhet në jo më pak se 1 (një) vit.

1.6 Provat e mostrave të farës së patates që hidhen në treg, në bazë të kërkesave të këtij vendimi, duhet të kryhen brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, në pikat zonale të miratuara me urdhër të ministrit.

1.7 Forma dhe përmbajtja e dokumentacionit që i bashkëngjitet kërkesës për testim jepen në shtojcën V, bashkëlidhur këtij vendimi.

V. DISPOZITA TË FUNDIT

Ngarkohen Enti Shtetëror i Farave dhe Fidanëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Edi Rama**

## SHTOJCA I

### KUSHTET MINIMALE QË DUHET TË PLOTËSOJË FARA E PATATES

1. **Fara bazë:**
   a. Në kontrollin zyrtarë të bimëve të patates në rritje numri i bimëve të prekura nga këmbëzeza nuk duhet të kalojë 1%.
   b. Numri i bimëve në vegjetacion, që manifestojnë rritje dhe zhvillim të ndryshëm nga varieteti, dhe numri i bimëve të varieteteve të tjera, të marra së bashku, nuk i kalon 0.1%, në pasardhësit e drejtpërdrejtë (mbjelljet e vitit pasardhës) nuk duhet të kalojë 0.25%.
   c. Në pasardhësit e drejtpërdrejt numri i bimëve me simptomat e infeksioneve nga virueset nuk duhet të kalojë 4%.
   d. Në kontrollet zyrtare të bimëve në vegjetacion, numri i bimëve me simptoma të mozaikut dhe numri i bimëve të prekura nga virusi spiral i gjethes, të marra së bashku, nuk duhet të kalojë 0.8%.
   e. Shkalla e lejuar e infeksionit për pikën 1 (c) dhe (d), do të jetë e pranueshme vetëm për raste kur sëmundjet virusale janë të shkaktuara nga viruset që janë të përhapura në Evropë.
   f. Numri maksimal i gjeneracioneve të farës bazë të patates do të jetë katër, ndërsa brezat e kombinuara të farës parabazë dhe të farës bazë duhet të jetë shtatë.
   g. Në etiketën zyrtare të duhet të ketë shënuar gjeneracionin, në të kundërt, fara në fjalë do të konsiderohet si farë që i përket brezit maksimal që është lejuar brenda kategorisë përkatëse për t'u hedhur në treg.
   h. Fara e patates (tuberët) nuk mund të hidhen në treg nëse në pjesën më të ngushtë të tuberit diametri më pak se 25-35 mm për cilësinë e klasit të parë dhe 35-45 mm për klasin e dytë.

2. **Fara e certifikuar:**
   a. Në kontrollin zyrtar të bimëve të patates në rritje numri i bimëve të prekur nga këmbëzeza nuk duhet të kalojë 4 %.
   b. Numri i bimëve në vegjetacion, që manifestojnë rritje dhe zhvillim të ndryshëm nga varieteti dhe numri i bimëve të varieteteve të tjera, të marra së bashku, nuk i kalon 0.5%, në pasardhësit e drejtpërdrejtë (mbjelljet e vitit pasardhës) nuk duhet të kalojë 0.5%.
   c. Në pasardhësit e drejtëpërdrejt numri i bimëve me simptomat e infeksioneve nga virueset nuk duhet të kalojë 10%.
   d. Në kontrollet zyrtare të bimëve në vegjetacion, numri i bimëve me simptoma të mozaikut dhe numri i bimëve të prekura nga virusi spiral i gjethes, të mara së bashku, nuk duhet të kalojë 6%.
   e. Shkalla e lejuar e infeksionit për pikën 2 (c) dhe (d), do të jetë e pranueshme vetëm për raste kur sëmundjet virusale janë shkaktuar nga viruset që janë të përhapura në Evropë.
   f. Në etiketën zyrtare të ketë shënuar gjeneracionin, në të kundërt, fara në fjalë do të konsiderohet si farë që i përket brezit maksimal që është lejuar brenda kategorisë përkatëse për t'u hedhur në treg.
   g. Fara e patates (tuberet) nuk mund të hidhen në treg nëse në pjesën më të ngushtë të tuberit diametri më pak se 25-35 mm për cilësinë e klasit të parë dhe 35-45 mm për klasin e dytë.

## SHTOJCA II

## KUSHTET MINIMALE TË CILËSISË QË DUHET TË PLOTËSOJË LOTI I FARËS SË PATATES

Kushtet minimale të lejuara lidhur me papastërtitë, lëndët e huaja, deformimet dhe sëmundjet si dhe pesha e lotit për patatet e farës duhet të jenë në kufijtë:

1. Prania e dheut dhe lëndëve të huaja: 1,0% e masës për farën bazë të patateve dhe 2,0% për patatet farë e certifikuar.
2. Kalbëzimi i thatë dhe i qullët, (për të dyja së bashku) kur nuk është shkaktuar nga subsp. endobioticum Synchytrium, Clavibacter michiganensis sepedonicus ose Ralstonia solanacearum: lejohet në masën 0,5%, por tuberet e prekura nga kalbëzimi i qullët nuk duhet të jenë më shumë se 0,2% të masës së lotit.
3. Zhardhokë të deformuar ose dëmtuar deri 3,0 % e masës së lotit.
4. Zhardhokët e prekur nga kroma e zakonshme në më shumë se 33% të sipërfaqes së zhardhokut, deri në 5% të masës së lotit.
5. Zhardhokët e prekur nga kroma e zezë në më shumë se 10% të sipërfaqes së tubereve: 5,0 % e masës.
6. Zhardhokët e prekur nga kroma e pluhurt që prekin në më shumë se 10% të sipërfaqes së tubereve: 3,0 % e masës;
7. Zhardhokët e vyshkur për shkak të dehidratimit apo dehidratimit të shkaktuar nga kroma e argjentë jo më shumë se 1,0 % e masës.
8. Për farat bazë kërkesat e pike 2-7 Toleranca totale për artikuj 2-7: 6,0% e masës për patatet që janë certifikuar si farë bazë, dhe 8,0% e masës për patatet farë e certifikuar
9. Kur në një lot fara e kategorisë farë bazë është e prekur nga më shumë se dy sëmundje sipas pikave (2-7) maksimumi i lejuar i prekjes është 6%, ndërsa për kategorinë farë e certifikuar maksimumi i lejuar është 8%.
10. Një lot të mos përmbajë më shumë se 3% të peshës me zhardhokë më të vegjël se madhësia minimale e shënuar ose më shumë se 3% të peshës me zhardhokë më të mëdhenj se madhësia maksimale e shënuar.
11. Zhardhokë e patates të prekur nga vrugu nuk mund të hidhen në treg për t'u përdorur si material mbjellës.
12. Pesha e 1 (një) loti duhet të jetë jo më shumë se 40 ton

## SHTOJCA III

## ETIKETIMI

### I. ETIKETA ZYRTARE

**A. Informacioni i kërkuar**

1. Autoriteti certifikues ose inicialet e tij;
2. Numri i serisë së etiketës;
3. Numrin e referencës për lotin si dhe datën e lëshimit të etiketës:
4. Specia, treguar të paktën nën emrin e saj botanik, i cili mund të jepet në formë të shkurtuar dhe pa emra të autorëve, me germa latine.
5. Varieteti;
6. Kategoria;
7. Cilësia;
8. Vendi i prodhimit;
9. Deklarimi i peshës;
10. Përdorur ose jo kimikate.......
11. Përmasat minimale të etiketës 110 × 67 mm.

B. Ngjyra e etiketës dhe dokumenti brenda paketës

Etiketa duhet të jetë në ngjyrë të bardhë me një vijë ngjyrë vjollcë diagonale për "farat para bazë", me ngjyrë të bardhë për "farat bazë", me ngjyrë blu për "farat e certifikuara"
Dokumenti brenda paketës duhet të jetë i tillë që të mos zëvendësojë etiketën. Dokumenti nuk është i domosdoshëm nëse kërkesat janë të printuara me bojë të pashlyeshme mbi paketim, ose në qoftë se përdoret një etiketë ngjitëse ose një etiketë e përbërë nga një material rezistent.

## SHTOJCA IV

## FORMA DHE PËRMBAJTJA E DOKUMENTACIONIT QË I BASHKËNGJITET KËRKESËS PËR CERTIFIKIM.

Kërkesë për aplikim

**Drejtuar:** Entit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve (ESHFF).

**Tiranë**

Për prodhimin e materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, parashikuar në neni 12 të Ligjit Nr.10416, datë 07.04.2011 "*Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor*".

Të dhëna për furnizuesin:

1. Emri e mbiemri: ……………................
2. Adresa : ………………………
3. Emërtimi i subjektit dhe adresa: ………………………
4. Nr. NUIS: (nga QKR) …………………………

Të dhëna për përfaqësuesin e autorizuar:

1. Emri e mbiemri: ......................................
2. Adresa: ......................................
3. Nr personal i identifikimit: ……………………

Te dhëna mbi materialin mbjellës dhe shumëzues bimor që kërkohet të prodhohet;

| Nr | Specia | Varieteti | Kategoria | Sasia | Vendi i prodhimit* |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | | | | | |
| 2 | | | | | |
| 3 | | | | | |
| 4 | | | | | |
| 5 | | | | | |
| 6 | | | | | |

Furnizuesi:
Emri mbiemri firma dhe vula vendi dhe data:

**ENTI SHTETËROR I FARËRAVE DHE FIDANËVE**
**SEKTORI I CERTIFIKIMIT ZYRTAR**

*PROCESVERBAL MBI CAKTIMIN E NGASTRËS SË FARËS*

Mbahet sot, më datë ………………., në fermën/ekonominë ……………, fshati ………..., komuna…………………, qarku……………………..., për caktimin e ngastrës së farës të kulturës …………, kultivari………………….……, që do të mbillet me farë të riprodhimit …………………………, gjatë vitit……………. ..
Kjo ngastër fare caktohet në ekonominë e ……………………., me sip. ……….ha, në kushte (mbi ose nën ujë) ……………, dhe me distancë izolimi në hapësirë nga kultivarët e tjerë prej ………….. ml.
Për realizimin e prodhimit të farës prej ……………. kv, furnizuesi merr përsipër të zbatojë këto hallka të teknologjisë :
1. ………………………………………………………………………………………
2. ………………………………………………………………………………………
3. ………………………………………………………………………………………
4. ………………………………………………………………………………………
5. ………………………………………………………………………………………
6. ………………………………………………………………………………………
Pocesverbali mbahet në 3 (tri) kopje, njëra prej të cilave i lihet furnizuesit, një kopje mbahet nga specialisti farave të DB-së, dhe një kopje dorëzohet në sektorin e certifikimit pranë Entit Shtetëror të Farave dhe Fidanëve

**FURNIZUESI SPEC. FAR. DB** **SPEC. CERTIFIKIMIT ZYRTAR ESHFF**

**ENTI SHTETËROR I FARAVE DHE FIDANËVE**
**SEKTORI I CERTIFIKIMIT ZYRTAR**

## CERTIFIKATË E ORIGJINËS

**"PËR MATERIALIN MBJELLËS DHE SHUMËZUES BIMOR TË PRODHUAR NË VEND"**
(Bazuar në ligjin nr.10416, datë 7.4.2011, neni 16/c")

Në mbështetje të nenit 16/c, të ligjit nr.10416, datë 7.4.2011, "Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor", nën përgjegjësinë time personale dhe ligjore lëshoj këtë certifikatë origjine për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor, me të dhënat e më poshtme:

Specia ………………………….
Varieteti …………………………
Kategoria ………………………….
Cilësia ......................................
Numri referencës …………………………
Numri i serisë etiketës zyrtare ……………………........
Viti i Prodhimit …………………………
Vend origjina …………………………

**FURNIZUESI**
……………………………
( Firma, vula )

Tiranë, më……………………….;

**ENTI SHTETËROR I FARËRAVE DHE FIDANËVE**
**SEKTORI CERTIFIKIMIT ZYRTAR**

**AKT KONTROLLI**

PËR PARCELËN E FARËS

(Bazuar në nenin 16/a, të ligjit nr.10416, datë 7.4. 2011, "Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor").
I mbajtur sot, më datë ………………., në parcelat e prodhimit të materialit mbjellës dhe shumëzues bimor, të furnizuesit z…………………………… qarku .............., komuna …………………., parcela (vendodhja)……………………. mbi zbatimin e teknologjisë për prodhimin e farës specia …….............., kultivari…………………., riprodhimi..............., të mbjella në një sipërfaqe prej ……….. ha.
Nga kontrolli zyrtar rezultoi se janë zbatuar këto kërkesa teknike të përcaktuara;
……………………………………………………………………………………………
……………………………………………………………………………………………
……………………………………………………………………………………………
……………………………………………………………………………………………
………………………………………………………………………………………………
………………………………………………………………………………………………
………………………………………………………………………………………………
………………………………………………………………………………………………
…………………………………………………………………………………

Ky akt - kontroll mbahet në 3 (tre) kopje, njëra prej të cilave i lihet furnizuesit, një kopje mbahet nga specialisti farërave të DB-së, dhe një kopje dorëzohet në sektorin e certifikimit zyrtar pranë ESHFF.

**FURNIZUESI SPEC.FAR. DB-së SPEC.CERTIFIKIMIT ZYRTAR (ESHFF)**

## AKT- APROBIMI

PËR NGASTRËN E PRODHIMIT TË FARËS
(Bazuar në ligjin nr.10416, datë 7.4. 2011, neni 16, pika 1/a)

Sot, më datë ………………. nga specialistët e sektorit të certifikimit zyrtar të E.SH.F.F z……………………., u bë aprobimi fushor i ngastrës së farës (Nr. ose emri………………) në fermën/ekonominë e furnizuesit z………………………, fshati ……………………, komuna ..........

1. Nga të dhënat cilësore të farës rezulton :
Ngastra është mbjellë me farë: Specia, ……………........…,kultivari................ …………, riprodhimi ……………; sipërfaqja ……………..ha , dokumenti i origjinës......................
.........................................................................................................................................

2. Mbas verifikimit del se :
- Është siguruar izolimi …………………..ml.
- Është zbatuar teknologjia ………………….............., sipërfaqja e vlefshme për farë …………ha, kultivari (hibridi ) ………………., riprodhimi ……………., sasia e farës që parashikohet të merret ……………kv, kategoria ………………. .

3. Gjendja e zhvillimit të bimëve në çastin e aprobimit paraqitet :
…………………………………………………………………………………………………
…………………………………………………………………………………………………
…………………………………………………………………………………………………

4. Treguesit e Aprobimit fushor :
Pastërtia varietore ………………% (…………………..)
Pastërtia nga barërat e këqija ……………… % (…………………...)
Prekjet nga sëmundjet virusale ……………... % (…………………..)
Prekjet nga sëmundjet kërpudhore ………….......% (……………….....)
a) …………………………………………………… (………………………………… )
b) …………………………………………………… (…………………………………)
c) Dëmtime nga dëmtuesit ……………………… (………………………….... )

5. Detyrimet e furnizuesit për trajtimin deri në tregtim:
…………………………………………………………………………………………………
…………………………………………………………………………………………………
…………………………………………………………………………………………………
…………………………………………………………………………………………………

FURNIZUESI GRUPI I APROBIMIT

………………………….. ( ) ( )( )

## DEKLARATË KONFIRMITETI

Unë i nënshkruari…………………me licencë nr........ datë....... me NUIS...................me adresë ............…...., sot më datë ……….., deklaroj në përgjegjësinë time personale se materiali mbjellës bimor…………...........................................i prodhuar nga ana ime është konform këtij specifikimi teknik:

1. Është i shoqëruar me certifikatën e origjinës nr. ………., datë ………………
2. Është i shoqëruar me certifikatën fitosanitare nr. ………., datë ……………..
3. Specia …………………………….
4. Varieteti …………………………….
5. Riprodhimi …………………………....
6. Cilësia …………………………….
7. Është i ambalazhuar në ………………., me peshë …….
8. Është i etiketuar me etiketa të lëshuara nga …………………………………dhe i përket lotit nr. …………..

Lëshoj këtë deklaratë konfirmiteti komform Ligjit Nr. 10416, datë 07.04.2011, " Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor", neni 11 dhe 12 dhe mbaj përgjegjësi për vërtetësinë e specifikimeve teknike të bëra në këtë deklaratë.

DEKLARUESI

(……… …………………………, më datë ……………………

## <u>ETIKETA E PRODHUESIT</u>

| | |
|---|---|
| Emri i subjektit furnizues | ……………………………… |
| Numri NUIS: | ...........................................…… |
| Numri i licencës | …………………………... |
| Vendi i prodhimit | ……………………………… |
| Specia | ..........................................…….. |
| Varieteti | ……………………………… |
| Kategoria | ..........................................…… |
| Cil[sia | ……………………………… |
| Data e analizës | ……………………………… |
| Trajtimi (Emri i preparatit) | ……………………………… |
| Data e ambalazhimit | ……………………………… |
| Pesha e njësisë së paketimit | ……………………………… |

**ENTI SHTETËROR I FARAVE DHE FIDANEVE**

ETIKETA ZYRTARE
(për farën e patates)

Nr i serisë ……………………
Furnizuesi ………………......
Specia ……………………
Varieteti ……………………
Kategoria …………………
Cilësia ..............................
Nr. lotit ……………….....
Pesha ……………….....
Vendi i prodhimit ……………….....
Data ……………….....
Rianalizuar: PO / JO Data rianalizimit :...............................
Trajtuar me pesticide ose substanca të tjera kimike: PO / JO
Emri i preparatit ose i substancës:.........................................

ENTI SHTETËROR I FARAVE DHE FIDANAVE

SEKTORI I CERTIFIKIMIT ZYRTAR

PROCESVERBAL

Mbi verifikimin e specifikimeve teknike, dokumentacionit dhe kontrollin e cilësisë së farës.

Në zbatim të ligjit Nr 10416, datë 07. 04. 2011, "Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor", mes specialistëve të certifikimit zyrtar z..…………………………………………dhe furnizuesit z.……………………… sot me datë ………………, mbahet ky proces verbal, për verifikimin e treguesve cilësor dhe dokumentacionin për farën e prodhuar si vijon:

1. Furnizuesi …………......, ka prodhuar farë të species …………………. me këto tregues:

a. Varieteti …………………..
b. Riprodhimi …………………...
c. Viti i prodhimit ……………...........
d. Sasia …………………....
e. Nr. Lotit ……………………
f. Etiketa me nr. serisë ……….....................

Dokumentat që disponon :

a. Certifikatë origjine Nr……., datë ……………
b. Certifikatë fitosanitare Nr……., datë……………..
c. Akt Aprobimi Nr……., datë……………..
d. Deklaratë Konfirmiteti Nr……., datë……………..
e. Proces verb. e kontrollit Nr. ……, datë……………,

Nga verifikimit i dokumenteve si dhe nga rezultatet e analizave laboratorike rezulton se fara është e prodhuar në përputhje me specifikimet teknike. Për këtë duhet të pajiset me certifikatë zyrtare pasi subjekti të shlyej tarifën e certifikimit në shumën ………… lekë.

FURNIZUESI SPECIALISTËT E CERTIFIKIMIT ZYRTAR
……………………………. (…………………) (…………………)

**MINISTRIA E BUJQËSISË, USHQIMIT DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT**
**ENTI SHTETËROR I FARËRAVE DHE FIDANAVE**
**AUTORITETI CERTIFIKUES**

# CERTIFIKATË ZYRTARE

" PËR MATERIALIN MBJELLËS DHE SHUMËZUES BIMOR të PRODHUAR në VEND "

**/ FARËRA /**

**NR.______, DATË _______.**

Në mbështetje të neneve 17 e 18, të ligjit nr.10416, datë 7.4.2011, *"Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimore"*, sektori i certifikimit zyrtar, pasi administroi dokumentacionin teknik të përcaktuar në nenet 15 e 16, të këtij ligji, dhe e vlerësoi atë të rregullt, lëshon këtë certifikatë zyrtare për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor, farë patate, të prodhuar në vend, me të cilën konfirmon se:

Loti i farës së patates prodhuar nga furnizuesi____________________, sipas procedurave teknike të përcaktuara, është paisur me etiketën zyrtare të lëshuar nga E.SH.F.F dhe ka të dhënat që vijon;

Specia ......................................................
Varieteti ……………………………...................
Riprodhimi ......................................................
Cilësia ……………………………………………
Kodi furnizuesit ……………………………………………
Pesha e lotit ..……………………………………......
Lloji i njësisë ambalazhimit ……………………….....................
Pesha e njësisë së ambalazhimit ……………………………………............
Numri i serisë të etiketës zyrtare ……………………………..................
Ngjyra e Etiketës Zyrtare ……………………..........................

SEKTORI I CERTIFIKIMIT ZYRTAR

**PËRGJEGJËSI**

**Tiranë më ;.................................**

SHTOJCA V

DOKUMENTACIONI I TESTIMIT TË FARËS SË PATATES

# KËRKESË

ENTIT SHTETËROR TË FARAVE DHE FIDANËVE

## PËR REGJISTRIMIN E VARIETETIT/ SPECIES

Unë i nënshkruari ____________________; me cilësinë e krijuesit/prodhuesit/importuesit, kërkoj regjistrimin e varieteteve/specieve, sipas kërkesave të ligjit nr. 10416 datë 7.4.2011 "Për materialin mbjellës dhe shumëzues bimor". (varietetit) ________________ )

Varieteti rrjedh ____________________ (*përmend prindërit që janë kryqëzuar ose sisteme të tjera të krijimit të tij*). Në rastin e hibridit trego formulën e saktë duke theksuar nëse bëhet fjalë ose jo për hibride me formulë të thjeshtë.
Institucioni (ferma/ekonomia) ku mbahet varieteti i pastër ndodhet në qarkun ____________, komunën ___________ (ose bashkinë) ______________ fshatin ___________dhe nëse është importuar, ardhur nga ___________ (*shteti*).

Unë i nënshkruari __________________ deklaroj se për këtë varietet është /nuk është paraqitur, kërkesa për regjistrimin e tij në vendet e BE-së ose vende të tjera që zbatojnë skemat e testimit të cilat përputhen me kërkesat e këtij vendimi. Në rast se është paraqitur kërkesë për regjistrim, për varietetet e importuara përmend shtetin ku është aplikuar për rregjstrim. (shteti:_____________________)

Bashkangjitur do të gjeni:
a) Përshkrimin e varietetit në skedën përkatëse;
b)Riprodhime fotografike ose fotografi të bimës ose pjesëve të saj që shërbejnë për identifikimin e saktë të varietetit;
c) Rezultatet e provave eksperimentale të kryera në vendin tonë ose jashtë tij.

KËRKUESI (ADRESA)_________________
Firma __________________________
Data ___________________________

## SASITË E KAMPIONIT TË FARËS SË PATATES PËR PROVA PËR TESTIM

**A) Kultura bujqësore (Patate):**

Sasia e nevojshme e farës për testim është përcaktuar në Udhëzimin e Ministrisë Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujrave, datë 16.02.2012.
1. Patate 150 (njëqind e pesëdhjetë) kg për 2 (dy) vjet rresht.

**VENDIM**
**Nr. 575, datë 24.6.2015**

## PËR MIRATIMIN E KËRKESAVE PËR MENAXHIMIN E MBETJEVE INERTE

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 37, të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mjedisit dhe ministrit të Transportit dhe Infrastrukturës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte me qëllim mbrojtjen, ruajtjen dhe përmirësimin e cilësisë së mjedisit, si dhe mbrojtjen e shëndetit publik, përmes minimizimit të ndikimeve negative.

2. Miratimi i kërkesave për menaxhimin e mbetjeve inerte synon të disiplinojë procesin e grumbullimit, transportit, dorëzimit dhe trajtimit të mbetjeve inerte në fushën e ndërtimit, duke përcaktuar rregullat dhe kërkesat konkrete për subjektet që operojnë në këtë fushë.

3. Në këtë vendim përcaktohen:

a) detyrimet e zotëruesit të mbetjeve inerte dhe operatorit;

b) kërkesat për miratimin, ndërtimin dhe funksionimin e lendfilleve për mbetjet inerte e të venddepozitimeve të përkohshme të mbetjeve inerte;

c) kërkesat për subjektet, të cilat kryejnë punime në fushën e ndërtimit, riparimit, restaurimit apo të prishjes së objekteve që prodhojnë mbetje.

4. Termat e përdorur në këtë vendim kanë të njëjtin kuptim me termat e përdorur në ligjin nr. 10463, datë 22.9.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", të ndryshuar, dhe në ligjin nr. 107, datë 31.7.2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit".

Termi "Zotërues i mbetjeve inerte", në kuptimin e këtij vendimi, është person fizik ose juridik, i cili, gjatë aktivitetit të tij të ndërtimit, riparimit, restaurimit apo prishjes së objekteve, prodhon, transporton ose trajton mbetje inerte të cilat janë të renditura në kapitullin 17, të vendimit nr. 99, datë 18.2.2005, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e katalogut shqiptar të klasifikimit të mbetjeve", të ndryshuar.

5. Zotëruesi i mbetjeve inerte, i cili kryen përpunim paraprak, përzierje apo procese të tjera, që ndryshojnë natyrën ose përbërjen e këtyre mbetjeve, është i detyruar t'i ruajë, t'i transportojë dhe t'i dorëzojë ato në lendfill apo në venddepozitimin e përkohshëm në mënyrë të diferencuar, sipas përcaktimeve të vendimit nr. 371, datë 11.6.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për përcaktimin e rregullave për dorëzimin e mbetjeve të rrezikshme dhe miratimin e dokumentit të dorëzimit të mbetjeve të rrezikshme", si dhe vendimit nr. 229, datë 23.4.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme".

6. Zotëruesi i mbetjeve inerte është i detyruar t'i dorëzojë këto mbetje tek operatorët, të cilët janë të pajisur me leje mjedisore, sipas shtojcës 1, bashkëlidhur ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011, "Për lejet e mjedisit", të ndryshuar, dhe me licencë të tipit III.2.B, sipas vendimit nr. 538, datë 26.5.2009, të Këshillit të Ministrave, "Për licencat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta".

7. Zotëruesit e mbetjeve inerte dhe operatorët e lendfilleve të mbetjeve inerte janë të detyruar të plotësojnë dhe të nënshkruajnë dokumentin e transferimit të këtyre mbetjeve dhe të dhënat regjistrohen në Regjistrin e Transfertave Individuale, sipas vendimit nr. 229, datë 23.4.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për miratimin e rregullave për transferimin e mbetjeve jo të rrezikshme dhe të dokumentit të transferimit të mbetjeve jo të rrezikshme".

8. Njësitë e qeverisjes vendore, në dokumentacionin e lëshimit të lejes për projektin e ndërtimit, riparimit, restaurimit apo shembjes, përcaktojnë se personi fizik ose juridik, të cilit i është dhënë leja për realizimin e projektit, duhet të provojë me dokumentacionin e nevojshëm përmbushjen e kërkesave të këtij vendimi brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e përfundimit të projektit të ndërtimit, riparimit, restaurimit apo prishjes së objektit, i cili krijon mbetje inerte.

9. Brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e përfundimit të zbatimit të projektit, të përcaktuar në pikën 7 të këtij vendimi, personi fizik ose juridik, të cilit i është dhënë leja për realizimin e projektit, paraqet pranë Agjencisë Kombëtare të Mjedisit kopje të dokumentacionit që provojnë përmbushjen e kërkesave të këtij vendimi.

10. Subjekti fizik/juridik, kërkues i lejes për ndërtimin, riparimin, restaurimin apo shembjen e objektit, përpara marrjes së lejes së ndërtimit duhet të depozitojë një garanci financiare për llogari të NJQV-së, e cila nuk do të jetë më e vogël se 3% e vlerës së strukturës së objektit dhe përcaktohet me vendim të këshillit të NJQV-së.

11. Garancia financiare i kthehet subjektit fizik/juridik pa interes nga NJQV-ja, e cila ka lëshuar

lejen e ndërtimit, pasi të provojë se mbetjet inerte janë dorëzuar, sipas pikave 4, 5 dhe 6, të këtij vendimi, në lendfillin ose në venddepozitimin e përkohshëm të përcaktuar nga NJQV-ja. Në rast të mospërmbushjes së kushteve të sipërpërmendura, NJQV-ja konfiskon garancinë financiare.

12. Subjekti fizik/juridik, që prodhon mbetje inerte gjatë ndërtimit, riparimit, restaurimit apo shembjes së objektit, është përgjegjës për dëmet e drejtpërdrejta ndaj palëve të treta që dëmtohen nga ushtrimi i aktivitetit të tyre dhe nga detyrimet kontraktuale.

13. Njësitë e qeverisjes vendore, në planet e përgjithshme vendore, të hartuara sipas nenit 20, të ligjit nr. 107/2014, datë 31.7.2014, "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", si dhe planet vendore të menaxhimit të integruar të mbetjeve të hartuara sipas nenit 13, të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", të ndryshuar, duhet të parashikojnë vende për depozitimin e përkohshëm të mbetjeve inerte dhe lendfillet për mbetjet inerte.

14. Në vendin për depozitimin e përkohshëm të mbetjeve inerte, të depozitohen jo më tepër se 20 tonë në ditë ose 3 500 tonë në vit mbetje inerte. Afati i dorëzimit të mbetjeve inerte në venddepozitimin e përkohshëm të jetë deri në momentin e ndërtimit të lendfillit për trajtimin e mbetjeve inerte në zonën më të afërt gjeografikisht të njësisë së qeverisjes vendore.

15. Zotëruesit e mbetjeve inerte janë të detyruar të dorëzojnë mbetjet inerte në venddepozitimin e përkohshëm ose lendfillet e trajtimit të mbetjeve inerte, kundrejt tarifës për ton/mbetje, të propozuar nga operatori dhe të miratuar nga njësitë e qeverisjes vendore.

16. Tarifa e përcaktuar për trajtimin e mbetjeve inerte në lendfille duhet të mbulojë koston e operimit për trajtimin e këtyre mbetjeve, si dhe koston për mbylljen e kujdesin pas mbylljes së lendfillit për një periudhë prej të paktën 30 (tridhjetë) vjetësh.

17. Ndalohet ndërtimi i venddepozitimeve të përkohshme të mbetjeve inerte nga njësitë e qeverisjes vendore në zonat e mëposhtme:

a) Zonat e mbrojtura, arkeologjike, turistike apo në çdo zonë që mbrohet me një akt normativ;

b) Zonat në distancë 300 metra nga një pus furnizues me ujë dhe çdo burim tjetër ujor;

c) Zonat në distancë 100 metra nga një përrua, argjinaturë lumore, liqen, lum ose kompleks ligatinor;

ç) Zonat në distancë 300 metra nga një zonë e mbrojtur në përputhje me shkronjën "a".

18. Ndërtimi i lendfillit të mbetjeve inerte kryhet nga subjekte të licencuara, në përputhje me kriteret e përcaktuara në vendimin nr. 452, datë 11.7.2012, të Këshillit të Ministrave, "Për lendfillet e mbetjeve", dhe përkatësisht:

a) kërkesat e përgjithshme për të gjitha kategoritë e lendfilleve;

b) procedurat dhe kriteret e pranimit të mbetjeve;

c) vlerësimin e sigurisë për pranimin e mbetjeve në venddepozitimet nëntokësore;

ç) përmbledhjen e opsioneve të asgjësimit në lendfill;

d) procedurën e kontrollit dhe vetëmonitorimit në fazat e operimit dhe kujdesit pas mbylljes.

19. Lendfillet e mbetjeve inerte mund të jenë lendfille vendore, të cilat shërbejnë për trajtimin e mbetjeve të prodhuara brenda territorit të një NJQV-je ose lendfille rajonale, të cilat shërbejnë për trajtimin e mbetjeve të shumë NJQV-ve. Njësitë e qeverisjes vendore bashkëpunojnë me njëra-tjetrën për përcaktimin e vendit ku do të ndërtohet lendfilli rajonal dhe të mënyrës së funksionimit të tij.

20. Operatorët, të cilët merren me trajtimin e mbetjeve në lendfille dhe venddepozitimet e përkohshme, janë të detyruar të raportojnë pranë NJQV-ve dhe Agjencisë Kombëtare të Mjedisit për të dhënat e mbetjeve që trajtojnë. NJQV-të duhet, që, brenda muajit janar të çdo viti, të dërgojnë te ministria që mbulon infrastrukturën publike të dhënat vjetore për mbetjet e trajtuara në lendfille dhe venddepozitime të përkohshme të mbetjeve inerte.

21. Njësitë e qeverisjes vendore, në bashkëpunim me ministrinë përgjegjëse për infrastrukturën publike, brenda afatit 2-vjeçar nga hyrja në fuqi e këtij vendimi, duhet të përcaktojnë vendet përkatëse për venddepozitimet e përkohshme dhe lendfillet për trajtimin e mbetjeve inerte, bazuar në kriteret e përcaktuara në këtë vendim dhe vendimin nr. 452, datë 11.7.2012, të Këshillit të Ministrave, "Për lendfillet e mbetjeve".

22. Shkeljet e kërkesave të këtij vendimi, që nuk përbëjnë vepër penale, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe dënohen me sanksione të përcaktuara në pikën 35, të nenit 62, të ligjit nr. 10463, datë 22.9.2011, "Për menaxhimin e integruar të mbetjeve", të ndryshuar.

23. Ngarkohen inspektorati kombëtar përgjegjës për mjedisin, inspektorati kombëtar përgjegjës për ndërtimet, si dhe inspektoratet vendore përgjegjëse për ndërtimet që të ushtrojnë kontrolle të vazhdueshme mbi zotëruesit e mbetjeve inerte, venddepozitimet e

përkohshme dhe lendfillet për trajtimin e tyre.

24. Me hyrjen në fuqi të këtij vendimi, rregullorja nr. 1, datë 30.3.2007, e ministrit të Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave dhe ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, "Për trajtimin e mbetjeve të ndërtimit, nga krijimi, transportimi e deri tek asgjësimi i tyre", shfuqizohet.

25. Ngarkohen Ministria e Mjedisit, Ministria e Transportit dhe Infrastrukturës, inspektorati kombëtar përgjegjës për ndërtimet dhe organet e njësive të qeverisjes vendore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Edi Rama**

## VENDIM
## Nr. 576, datë 24.6.2015

## PËR SHPRONËSIMIN, PËR INTERES PUBLIK, TË PRONARËVE TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, PRONË PRIVATE, QË PREKEN NGA NDËRTIMI I LINJËS 110 KV LLAPAJ - PESHKOPI

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 20 e 21, të ligjit nr. 8561, datë 22.12.1999, "Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë, pronë private, për interes publik", me propozimin e ministrit të Energjisë dhe Industrisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpronësimin, për interes publik, të pronarëve të pasurive të paluajtshme, pronë private, që preken nga ndërtimi i linjës 110 kV Llapaj - Peshkopi, sipas tabelës që i bashkëlidhet këtij vendimi.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Operatorit të Sistemit të Transmetimit (OST) sh.a.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme, që shpronësohen, të kompensohen në vlerë të plotë, sipas masës përkatëse të kompensimit, që paraqitet në tabelën që i bashkëlidhet këtij vendimi, për sipërfaqen 941 (nëntëqind e dyzet e një) m², tokë bujqësore "arë", "truall" dhe "kullotë", në një vlerë të përgjithshme shpronësimi 111 039 (njëqind e njëmbëdhjetë mijë e tridhjetë e nëntë) lekë.

4. Vlera e përgjithshme e shpronësimit, prej 111 039 (njëqind e njëmbëdhjetë mijë e tridhjetë e nëntë) lekësh, të përballohet nga fondet e OST sh.a.

5. Shpenzimet procedurale të shpronësimit të përballohen nga OST sh.a., si subjekti që garanton shpenzimet për realizimin e këtij procesi.

6. Shpronësimi të fillojë brenda muajit qershor 2015.

7. Zyra Qendrore e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme dhe zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme Dibër dhe Kukës të marrin masat për pezullimin e të gjitha transaksioneve mbi këto pasuri, deri në përfundim të procesit të kalimit të pronësisë së pasurive të shpronësuara në favor të OST sh.a.

8. Ngarkohen Ministria e Energjisë dhe Industrisë, OST sh.a. dhe zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Edi Rama**

LISTA E PRONARËVE QË SHPRONËSOHEN PËR EFEKT TË NDËRTIMIT TË LINJËS 110 kV LAPAJ - PESHKOPI

**Lloji i pasurisë së paluajtshme që shpronësohet: TOKË ARË, TRUALL, KULLOTË NË QENDËR**

| Nr. | Numri i shtyllës | Të dhëna për pronësinë | | | | | | | Sip. shpronësimi për shtyllë m² | Vlera e shpronësimit në lekë/m² | Vlera e shpronësimit në lekë për shtyllë |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Emri | Atësia | Mbiemri | Nr. kadastral | Nr. i pasurisë | Lloji i pasurisë | Sip. e pronës m² | | | |
| 1 | 2 | 3 | 4 | 5 | 6 | 7 | 8 | 9 | 10 | 11 | 12 |
| **Komuna Qendër Tomin** | | | | | | | | | | | |
| **Fshati Pollozhan** | | | | | | | | | | | |
| 1 | 2 | Pretendues | | | 3023 | 95 | arë | 14814 | 88 | 121 | 10648 |
| 2 | 3 | Pretendues | | | 3023 | 95 | arë | 14814 | 66 | 121 | 7986 |
| 3 | 4 | Pretendues | | | 3023 | 95 | arë | 14814 | 48 | 121 | 5808 |
| 4 | 5 | Pretendues | | | 3023 | 95 | arë | 14814 | 17 | 121 | 2057 |
| 5 | 6 | Flamur | | Cela | 3023 | 40/6 | arë | 5550 | 17 | 121 | 2057 |
| 6 | 8 | Kurt | | Salkurti | 3023 | 56/10 | arë | 2640 | 17 | 121 | 2057 |
| | | Baudin | | Salkurti | | 56/11 | arë | 2500 | | | |
| **Fshati Rashnapojë** | | | | | | | | | | | |
| 7 | 10 | Elmaz | | Bojku | 3155 | 35/6 | arë | 1000 | 15 | 121 | 1815 |
| **Fshati Pilafe** | | | | | | | | | | | |
| 8 | 11 | Ismail | | Cenga | 2958 | 125/34 | arë | 2375 | 15 | 121 | 1815 |
| 9 | 12 | Ruzhdi | | Muda | 2958 | 117/6 | arë | 508 | 15 | 121 | 1815 |
| **Komuna Kastriot** | | | | | | | | | | | |

| | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| **Fshati Barovjan** | | | | | | | | | | | |
| 10 | 16 | Ramadan | | Shehu | 1252 | 63/11 | arë | 4500 | 17 | 121 | 2057 |
| **Fshati Brest i Sipërm** | | | | | | | | | | | |
| 11 | 23 | Dije | | Shini | 1280 | 57/5 | arë | 3770 | 17 | 121 | 2057 |
| 12 | 24 | Pretendues | | | 1280 | 10/38 | arë | 875 | 18 | 121 | 2178 |
| 13 | 25 | Pretendues | | | 1280 | 2/4 | kullotë | 3900 | 15 | 105 | 1575 |
| **Fshati Sohodoll** | | | | | | | | | | | |
| 14 | 27 | Riza | | Doci | 2113 | 69/2/1 | arë | 3000 | 40 | 121 | 4840 |
| **Komuna Fushë-Cidhen** | | | | | | | | | | | |
| **Fshati Renz** | | | | | | | | | | | |
| 15 | 35 | Agim | | Spata | 3169 | 17/33 | arë | 1100 | 17 | 121 | 2057 |
| 16 | 36 | Pretendues | | | 3169 | 12/20 | arë | 10750 | 18 | 121 | 2178 |
| 17 | 38 | Pretendues | | | 3169 | 9/11 | arë | 1000 | 15 | 121 | 1815 |
| **Komuna Sllovë** | | | | | | | | | | | |
| **Fshati Shumbat** | | | | | | | | | | | |
| 18 | 42 | Pretendues | | | 3442 | 842 | arë | 422 | 15 | 121 | 1815 |
| **Fshati Sllatinë** | | | | | | | | | | | |
| 19 | 46 | Pretendues | | | 3475 | 849 | arë | 2240 | 15 | 121 | 1815 |
| 20 | 47 | Pretendues | | | 3475 | 869 | arë | 2625 | 45 | 121 | 5445 |
| 21 | 48 | Pretendues | | | 3475 | 832 | arë | 17434 | 35 | 121 | 4235 |
| 22 | 49 | Hajrulla | | Hysa | 3475 | 1129 | arë | 2550 | 15 | 121 | 1815 |
| 23 | 50 | Beniamin | | Cekici | 3475 | 811/2 | arë | 1512 | 15 | 121 | 1815 |
| 24 | 54 | Pretendues | | | 3475 | 112 | arë | 1840 | 51 | 121 | 6171 |
| **Fshati Veleshë** | | | | | | | | | | | |
| 25 | 61 | Isuf | | Hoxha | 3799 | 199 | arë | 514 | 15 | 121 | 1815 |
| **Fshati Kalle** | | | | | | | | | | | |
| 26 | 65 | Pretendues | | | 2048 | 344 | arë | 5108 | 15 | 121 | 1815 |
| 27 | 66 | Beqir | | Sinani | 2048 | 335/2 | arë | 1631 | 17 | 121 | 2057 |
| **Komuna Kala Dodës** | | | | | | | | | | | |
| **Fshati Shullan** | | | | | | | | | | | |
| 28 | 70 | Pretendues | | | 3440 | 111 | arë | 1540 | 45 | 121 | 5445 |
| 29 | 71 | Pretendues | | | 3440 | 131 | kullotë | 18684 | 35 | 87 | 3045 |
| 30 | 72 | Pretendues | | | 3440 | 5 | arë | 17482 | 18 | 121 | 2178 |
| **QARKU KUKËS** | | | | | | | | | | | |
| **Komuna Bushtricë** | | | | | | | | | | | |
| **Fshati Palush** | | | | | | | | | | | |
| 31 | 81 | Isuf | Azem | Poti | 2868 | 480/7 | arë | 2800 | 18 | 114 | 2052 |
| **Fshati Bushtricë** | | | | | | | | | | | |
| 32 | 85 | Pretendues | | | 1333 | 807 | arë | 6200 | 26 | 114 | 2964 |
| 33 | 86 | Pretendues | | | 1333 | 771/5 | arë | 608 | 15 | 114 | 1710 |
| 34 | 87 | Pretendues | | | 1333 | 556 | arë | 2800 | 15 | 114 | 1710 |
| 35 | 89 | Pretendues | | | 1333 | 988 | kullotë | 24852 | 23 | 105 | 2415 |
| 36 | 90 | Pretendues | | | 1333 | 243/3 | kullotë | 12600 | 15 | 105 | 1575 |
| 37 | 91 | Hysen | Osman | Gjici | 1333 | 240/5 | arë | 595 | 15 | 114 | 1710 |
| | | Ismen | Hakik | Gjici | 1333 | 240/8 | | 340 | | | |
| 38 | 95 | Hysni | Brahim | Billa | 1333 | 24/8 | arë | 1750 | 23 | 114 | 2622 |
| **Sipërfaqe totale për shpronësimi në m²** | | | | | | | | | **941** | | |
| **SHUMA TOTALE NË LEKË PËR SHPRONËSIM** | | | | | | | | | **111039** | | |

## VENDIM
## Nr. 577, datë 24.6.2015

## PËR NGRITJEN E RRJETIT TË NJËSIVE TË INTEGRIMIT EVROPIAN DHE RRJETIT TË NJËSIVE TË HARTIMIT TË LEGJISLACIONIT NË MINISTRITË E LINJËS

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 70, të Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Komuniteteve Evropiane të shteteve të tyre anëtare, ratifikuar me ligjin nr. 9590, datë 27.7.2006, me propozimin e Kryeministrit, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ngritjen e rrjetit të njësive të integrimit evropian, si strukturë e veçantë, dhe rrjetit të njësive të hartimit të legjislacionit, në përbërje të të gjitha ministrive, me qëllim përmirësimin dhe rritjen e cilësisë së hartimit të legjislacionit dhe përafrimit të tij me *acquis* të BE-së.

2. Në ato ministri dhe në Departamentin e Administratës Publike (DAP), ku mungojnë sektorët e hartimit të legjislacionit, sekretarët e përgjithshëm dhe titullari i DAP-it përcaktojnë nëpunës të strukturës, si nëpunës të përfshirë në procesin e hartimit të legjislacionit, pjesë të rrjetit të njësive të hartimit të legjislacionit, në përputhje me nevojat e tyre, por, në çdo rast, jo më shumë se 3.

3. Rrjeti i njësive të integrimit evropian dhe rrjeti i njësive të hartimit të legjislacionit bashkërendojnë dhe mbështetin punën e institucioneve respektive për hartimin e një legjislacioni koherent, të qartë dhe transparent, si dhe për transpozimin dhe zbatimin e *acquis*, sipas kapitujve përkatës, në zbatimin e Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit.

4. Njësia e integrimit evropian është përgjegjëse, për:

a) bashkërendimin e brendshëm institucional, sigurimin e lidhjes së drejtpërdrejtë dhe bashkërendimin

e punës me Ministrinë e Integrimit Evropian dhe me ministritë e tjera të linjës për angazhimet e marra nga Republika e Shqipërisë, në kuadër të procesit të stabilizim-asociimit;

b) bashkërendimin e brendshëm institucional dhe bashkërendimin e punës me Ministrinë e Integrimit Evropian dhe ministritë e tjera të linjës, për procesin e përafrimit të legjislacionit vendas me *acquis* dhe për raportimin e akteve normative, që adaptojnë *acquis* të BE-së;

c) bashkërendimin e brendshëm institucional për përgatitjen e raporteve për procesin e integrimit evropian;

ç) monitorimin dhe raportimin brenda ministrisë për çështje të integrimit evropian;

d) shpërndarjen e të dhënave për procesin e integrimit evropian ndërmjet ministrisë ku bën pjesë, Ministrisë së Integrimit Evropian dhe njësive të integrimit evropian në ministritë e tjera të linjës;

dh) vlerësimin e veprimtarisë së institucionit në raport me ecurinë e procesit të integrimit evropian, propozimin e mekanizmave funksionalë për lehtësimin e zbatimit të reformave sektoriale nga zbatimi i Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit, përmes procesit të përafrimit të legjislacionit vendas me *acquis* dhe ngritjes së kapaciteteve administrative;

e) bashkërendimin dhe koordinimin e procesit të programimit e të zbatimit të fondeve të Instrumentit të Paraaderimit IPA II, që i akordohen Shqipërisë në kuadër të integrimit evropian;

ë) koordinimin e procesit të evidentimit të nevojave të sektorit përkatës për financim nga BE-ja dhe/apo donatorë të tjerë në përputhje me strategjitë sektoriale;

f) mbështetjen teknike të mbledhjeve të grupeve të përhershme të punës, sipas kapitujve të *acquis*.

5. Njësia e hartimit të legjislacionit është përgjegjëse vetëm, për:

a) hartimin e legjislacionit në përputhje me standardet e teknikës legjislative;

b) bashkërendimin me strukturat teknike për përgatitjen e projektakteve;

c) bashkëpunimin me njësinë e integrimit evropian dhe Ministrinë e Integrimit Evropian për garantimin e përputhshmërisë së legjislacionit vendës me *acquis* të BE-së;

ç) çdo detyrë tjetër të lidhur me procesin e hartimit të legjislacionit.

6. Në funksion të përmbushjes dhe realizimit të detyrave të lidhura me hartimin e legjislacionit të rrjetit të njësive të hartimit të legjislacionit, pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të Ministrave krijohet një komision me ekspertë të jashtëm, njohës të mirë të fushave të legjislacionit, sipas rastit, për të mbështetur dhe asistuar këtë rrjet në hartimin e akteve ligjore e nënligjore, si dhe dokumenteve të tjera ligjore.

7. Rregullat më të hollësishme për mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të rrjetit, si dhe të komisionit me ekspertë të jashtëm, të përmendur në pikën 6 të këtij vendimi, përcaktohen në rregulloren e veçantë, miratuar nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave.

8. Anëtarët e komisionit me ekspertë të jashtëm përzgjidhen nga Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, duke u bazuar në kritere të tilla, si: përvoja e gjatë në fushën e hartimit të legjislacionit dhe të dokumenteve ligjore, përvoja e gjatë në administratën shtetërore, njohja e legjislacionit ndërkombëtar dhe atij evropian.

Anëtarët e komisionit me ekspertë të jashtëm bëjnë deklarimin e gjendjes së konfliktit të interesit, sipas rastit.

9. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, në cilësinë e autoritetit mbikëqyrës dhe kontrollues të procesit të hartimit të legjislacionit, sa herë e gjykon të nevojshme, thërret mbledhjen e komisionit me ekspertë të jashtëm dhe të nëpunësve të ngarkuar me hartimin e legjislacionit, të këtij rrjeti.

Orientimet, udhëzimet dhe detyrat e lëna prej tij në mbledhjet e punës janë të detyrueshme për zbatim.

10. Sekretari i Përgjithshëm i Këshillit të Ministrave, në cilësinë e autoritetit mbikëqyrës dhe kontrollues të procesit të hartimit të legjislacionit, i dërgon vlerësime zyrtarit raportues të nëpunësit civil, të përfshirë në procesin e hartimit të legjislacionit.

Ky vlerësim merret në konsideratë në procesin e vlerësimit të rezultateve në punë të nëpunësit civil.

11. Anëtarët e komisionit me ekspertë të jashtëm marrin një shpërblim, në masën 70 000 (shtatëdhjetë mijë) lekë në muaj.

12. Ministritë dhe institucionet qendrore në varësi të Kryeministrit ose të ministrave sigurojnë bashkëpunim institucional, nëpërmjet vënies në dispozicion të të dhënave, informacioneve apo çdo lloj ndihme tjetër, në përputhje me procedurat e përcaktuara në vendimin nr. 867, datë 10.12.2014, të Këshillit të Ministrave, "Për procedurat e bashkëpunimit në institucionet e administratës shtetërore".

13. Efektet financiare, që rrjedhin nga pagesa e anëtarëve të komisionit me ekspertë të jashtëm dhe çdo

shpenzim tjetër administrativ, të përballohen nga buxheti vjetor i miratuar për Kryeministrinë.

14. Ngarkohen institucionet e përcaktuara në pikat 1 e 2 të këtij vendimi dhe Ministria e Integrimit Evropian për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
**Edi Rama**

## VENDIM
## Nr. 578, datë 24.6.2015

## PËR NJË SHTESË NË VENDIMIN NR. 545, DATË 11.8.2011, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR MIRATIMIN E STRUKTURËS DHE TË NIVELEVE TË PAGAVE TË NËPUNËSVE CIVILË/NËPUNËSVE, ZËVENDËSMINISTRIT DHE NËPUNËSVE TË KABINETEVE NË KRYEMINISTRI, APARATET E MINISTRIVE TË LINJËS, ADMINISTRATËN E PRESIDENTIT, KUVENDIT, KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE, PROKURORINË E PËRGJITHSHME, DISA INSTITUCIONE TË PAVARURA, INSTITUCIONET NË VARËSI TË KRYEMINISTRIT, INSTITUCIONET NË VARËSI TË MINISTRAVE TË LINJËS DHE ADMINISTRATËN E PREFEKTIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 4/2, të ligjit nr. 10405, datë 24.3.2011, "Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve", të nenit 7, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, të ligjit nr. 9584, datë 17.7.2006, "Për pagat, strukturat dhe shpërblimet e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe institucioneve të tjera të pavarura, të krijuara me ligj", dhe të ligjit nr. 160/2014, "Për buxhetin e vitit 2015", me propozimin e ministrit të Shtetit për Inovacionin dhe Administratën Publike dhe ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 4/13, të vendimit nr. 545, datë 11.8.2011, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, shtohet pika 4/14 me këtë përmbajtje:

"4/14. Nëpunësit në njësitë e integrimit evropian dhe ato të menaxhimit të fondeve IPA në ministritë e linjës, nëpunësit e ngarkuar me përafrimin e legjislacionit dhe programimin e monitorimin e asistencës së BE-së në Ministrinë e Integrimit Evropian, nëpunësit e ngarkuar me hartimin e legjislacionit në ministritë e linjës, nëpunësit në Drejtorinë e Përgjithshme të Kodifikimit në Ministrinë e Drejtësisë, drejtori i Departamentit të Legjislacionit në Kryeministri, nëpunësit e ngarkuar me hartimin e legjislacionit në njësinë e legjislacionit dhe akteve të Këshillit të Ministrave në Kryeministri, si dhe nëpunësit, të cilët janë të ngarkuar me integrimin dhe hartimin e akteve ligjore e nënligjore (jo më shumë se 3 nëpunës) në Departamentin e Administratës Publike, në masën 100 000 (njëqind mijë) lekë në muaj.

Zbatimi i kësaj shtese për nëpunësit e sipërpërmendur bëhet sipas përshkrimit të pozicionit të punës dhe pas miratimit paraprak të Departamentit të Administratës Publike dhe të drejtorit të Departamentit të Legjislacionit në Kryeministri, për nëpunësit e ngarkuar me hartimin e legjislacionit, dhe të Ministrisë së Integrimit Evropian, për nëpunësit në njësitë e integrimit evropian dhe të menaxhimit të fondeve IPA në ministritë e linjës.

Në rast se për nëpunësit e sipërcituar parashikohen në këtë vendim shtesa të tjera për kushte pune, këta nëpunës zgjedhin ndërmjet dy shtesave, por në asnjë rast nuk mund t'i përfitojnë të dyja shtesat.".

2. Efektet financiare që rrjedhin nga zbatimi i këtij vendimi për vitin 2015, të përballohen nga fondet e miratuara për secilin institucion për vitin 2015.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare duke filluar nga data 1 shtator 2015.

KRYEMINISTRI
**Edi Rama**

| | |
|---|---|
| | Formati 61x86/8 |

Shtypshkronja e Qendrës së Botimeve Zyrtare
Tiranë, 2015

Adresa
Bulevardi "Gjergj Fishta",
pas ish-Ekspozitës"Shqipëria Sot",
Tel:042427005, 04 2427006

Çmimi 602 lekë